



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
Hospitaland University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës- Universitetski Klinikcki Centar
Kosova – University Clinical Center of Kosovo

Raporti vjetor i punës në SHSKUK-së

Janar - Dhjetor 2023

Prishtinë

Mars, 2024

Shkurtesat:

SHSKUK- Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

MSH- Ministria e Shëndetësisë

BD- Bordi Drejtues

MFPT- Ministria e Financave Punës dhe Transfereve

QKUK- Qendra Klinike Universitare e Kosovës

QKSUK- Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës

QKMP- Qendra Kombëtare e Mjekësisë Punës

QKMS- Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive

QKTK- Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës

SP- Spitali i Përgjithshëm

QSHM-SHIB- Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi

QIRSKP- Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik

BQ- Barnatorja Qëndrore

AM- Autorizim Marketing

LE- Lista Esenciale

Përmbajtja:

Përmbledhje.....	5
Hyrje.....	6
1. Struktura e të punësuarve në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.....	18
2. Shërbimet e kryera sipas njësive të SHSKUK-së, Janar-Dhjetor 2023.....	19
3. Performanca e punës në SHSKUK-së Janar-Dhjetor 2023.....	21
3.1. Numri i pacientëve dhe ditët e shërimit sipas njësive në SHSKUK, Janar-Dhjetor 2023.....	22
3.2. Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të shërimit në SHSKUK, Janar-Dhjetor 2023.....	22
3.3. Krahësimi i shërbimeve të kryera në SHSKUK-së sipas viteve 2022-2023.....	23
3.4. Krahësimi i shfrytëzueshmërisë së kapaciteteve dhe ditët e shërimit në QKUK dhe Spitale 2022/2023.....	25
3.5. Krahësimi i numrit të shtretëve dhe numri i pacientëve të shtrirë sipas njësive 2022/2023.....	25
4. Struktura e të punësuarve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës QKUK.....	26
5. Shërbimet e përgjithshme të kryera në QKUK Janar-Dhjetor 2023.....	27
6. Performanca e punës në Qendrën Klinike Universitar të Kosovës Janar-Dhjetor 2023.....	28
7. Shërbimet shëndetësore të ofruara sipas klinikave në QKUK -Janar-Dhjetor 2023.....	29
7.1. Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve në klinikat e kirurgjisë	30
7.2. Shfrytëzimi i kapaciteteve në klinikat internistike dhe klinikat tjera	31
7.3. Krahësimi i shërbimeve të indikatorëve kyq të përformancës në QKUK 2022/2023	32
7.4. Krahësimi i shfrytëzueshmërisë dhe mesatarja e ditëve të shërimit sipas klinikave të QKUK 2022/2023.....	33
8. Struktura kualifikuese e të punësuarve në Spitalet e Përgjithshme.....	34
9. Shërbimet e kryera në Spitale të Përgjithshme Janar-Dhjetor 2023.....	35
9.1. Performanca e spitaleve të përgjithshme të SHSKUK-së Janar- Dhjetor 2023.....	36
9.2. Krahësimi i shërbimeve të indikatorëve kyq të përformancës në spitale të përgjithshme 2022/2023	37
9.3. Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të shërimit sipas reparteve në spitale të përgjithshme 2023.....	38
10. Numri i të punësuarve në Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK).....	39
10.1. Shërbimet e ofruara nga Qendra Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK).....	39
11. Shërbimet e ofruara në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive-QKMS.....	40
12. Shërbimet e ofruara në Qendrën Kombëtare të Telemjekësisë së Kosovës –QKTK.....	41
13. Shërbimet e ofruara nga Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë-QKMP.....	42
14. Struktura e të punësuarve në Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi-QSHM/SHIB dhe QIRSKP.....	43
14.1. Shërbimet e ofruara nga Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi dhe QIRSKP-Shtime.....	44
15. Shërbime tjera të ofruara në SHSKUK-së.....	45
15.1. Lindjet e realizuar Janar-Dhjetor 2023 në njësit e SHSKUK-së.....	45
15.2. Shërbimet e dializës në SHSKUK-së, Janar-Dhjetor 2023	45
15.3. Shërbimet Radiologjike të kryera në SHSKUK Janar- Dhjetor 2023.....	46
15.4. Shërbimet e kryera në Klinikën e Kardiologjisë dhe Kardiokirurgjisë-2023.....	48
15.5. Shërbimet Onkologjike Janar-Dhjetor 2023.....	49
16. Pacientët e trajtuar me Covid-19, në njësit e SHSKUK-së- Janar-Dhjetor 2023.....	50
17. Lista e pritjes për kryerjen e shërbimeve në QKUK.....	51
17.1. Diagnozatat në listat e pritjes në klinikat e QKUK-së.....	52

18. Referimet për trajtimi mjekësore jashtë institucioneve të SHSKUK-së.....	53
19. Disa nga shkaqet dhe arsyet e mos ofrimit të shërbimeve në institucioneve publike.....	54
20. Frunizimi me produkte farmaceutike dhe material shpenzues sipas planifikimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023.....	55
21. Donacionet e pranuar në SHSKUK-së, Janar-Dhjetor 2023.....	56
22. Të hyrat në SHSKUK Janar-Dhjetor 2023.....	57
22.1. Realizimi buxhetit në SHSKUK për periudhën Janar-Dhjetor 2023.....	58
22.2. Obligimet e SHSKUK-së.....	58
23. Objektivat dhe aktivitete të realizuara Janar-Dhjetor 2023.....	59
24. Problemet dhe Sfidat e SHSKUK-së.....	67

DRAFT

Përmbledhje

Më lejoni që para jush të paraqes Raportin vjetor të punës së SHSKUK-së, Janar-Dhjetor 2023. Raporti përfshin shërbimet e përgjithshme të kryera në institucionet e SHSKUK-së, indikatorët kyç të performances si: shfrytëzueshmërin e kapaciteteve, mesataraj e ditëve të shërimit, numrit e vizitave ambulantore, shërbimet laboratorike, shërbimet tjera diagnostike dhe ato të veqanta. Investimet e realizuara, furnizimi me barna dhe material hargjues, aktivitetet kryesore të organizuara, donacionet e pranuar, shfrytëzueshmëria e buxhetit, realizimi i objektivave nga plani i punës, problemet dhe sfidat e SHSKUK-së, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, dhe krahasimi i shërbimeve sipas vitit 2022 dhe 2023.

Gjatë kësaj periudhe edhe për kundër sfidave të paraqitura me ndrrime të menaxhmenteve të SHSKUK-së, janë realizuar investime të ndryshme si: në rënvimin dhe ndërtimin e objekteve dhe krijimin e kushteve më të mira të punës, furnizimi dhe mirëmbajtje të pajisje, me barna dhe material harxhues, përpjekeje në reduktimin e listes së pritjes, fuqizimin dhe funksionalizimin e shërbimeve të reja dhe rritje të transparencës dhe llogaridhënies.

ShSKUK në njësit e saja ka të punësuar 7,137, si mjekë specialist 1,595, Infermierë me Bachelor 1,907, Infermirë me shkollim të mesëm 2,187, Bashkpunetor profesional 57, Numri i të punësuarve të angazhuar në mësimdhënie 73, Numri i të punësuarve si staf administrativ dhe teknik 1,211 dhe të punësuar të cilët kanë marrë pushim pa pages janë 107.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2023 në kuadër të SHSKUK-së, janë ofruar gjithësejt **8,046,049** shërbime të ndryshme. Nga këto shërbimet kemi **776,185** ditë shërimi me gjithësejt **149,148** pacientë të shtrirë në 3,686 shtretër.

Nga shërbimet e përgjithshme të kryera janë: Operime 41,158, Vizita ambulantore 1,442,984, Vizita tjera diagnostike 738,527, Paramentra laboratorik 4,221,986, për 825,339 pacientë. Shërbime të ndryshme imazherike-radiologjike 417,644, Shërbime tjera apo të veqanta janë kryer 1,045,366, numri i Dializave të kryer 120,704 dhe Lindje 17,710, nga këto lindje 6,671 janë lindje me operacion apo 38% e lindjeve, ndërsa fëmijë të lindur kemi 18,001.

Mesatarja e ditëve të shërimit për pacient në ShSKUK, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2023 është 5.2 ditë, ndërsa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve është 58%.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues nga lista eseciale për vitin 2023 SHSKUK-së, është furnizuar me Produkte farmaceutike 53% në përgjithësi, ndërsa me Material shpenzues ka qenë 67%.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor, ShSKUK ka përfituar donacione si produkte medicinale të rëndësisë vitale si : citostatik, barna antianemike, faktor koagulues, pajisje mjekësore dhe material shpenzues dhe tjera me vlerë 5,465,895.62 €.

Sipas të dhënave raportuese gjatë kësaj periudhe në kuadër të SHSKUK-së, sipas kategorive të planifikimit, shpenzueshmëria buxhetore është 98.5 %.

Të hyrat gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2023 në kuadër të SHSKUK kemi 3,871,888.90 euro, një rritje prej 16% në krahasim me vitin 2022.

Edhe gjatë këtij vitit ka vazhduar trajtimi spitalor i pacientëve me COVID-19, ku në njësit e SHSKUK është bërë trajtimi i 293 rasteve me COVID-19.

Sipas të dhënave të raportuara nga njësit e ShSKUK, në lidhje me listën e pritjes së pacientëve për kryerjen e shërbimeve është rreth 13,913 pacientë dhe afati kohor është nga një javë deri në pesë vite.

Kurse sa i përket numrit të referimeve për trajtim jashtë institucioneve publike kemi 1,144 pacientë. Arsyet e referimeve janë mungesë të aparaturës dhe hapsirave, mungesë të stafit të kualifikuar. Trajtim multidisiplinar dhe qendrat e specializuara dhe mungesa e aparaturës.

Sipas planit të punës së SHSKUK-së për vitin 2023, i përbërë prej 11 objektivave dhe 77 aktivitete. Gjatë kësaj periudhe nga 77 aktivitetet e planifikuara kanë përfunduar 23 aktivitete apo të shprehura në përqindje 30%. Kurse 35 aktivitete apo 45% që kanë filluar dhe janë në proces dhe 19 aktivitete apo 25% janë të pa përfunduar apo të pa realizuar.

Hyrje

Marrë parasysh objektivat dhe aktivitetet e planifikuara po vazhdon angazhimi në ngritjen e cilësisë së shërbimeve duke rritur hapsirën dhe shërbime të reja dhe përmirësimin e hapsirave dhe kushteve të punës. SHSKUK-së, po zgjeron gamën diagnostike duke decentralizuar shërbimet, ofruar sa më afër qytetarit në institucionet e ShSKUK-së, dhe në reduktimin e listave të pritjes për shërbimet shëndetësore.

Bazuar në planin e punës të aprovuar nga Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës më 27 mars 2023 me nr. Prot. 1135, i bazuar në prioritetet që kanë të bëjnë në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të sigurt shëndetësore, furnizim të qëndrueshëm me barna dhe material mjekësor, funksionalizimin e shërbimeve të reja, përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës spitalore, digjitalizimin e disa shërbimeve, mbikqyrje shëndetësore për të punësuarit, kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve brenda spitalore, në përputhje me nevojat dhe mundësitë buxhetore të SHSKUK-së, për vitin 2023, ishin synimet kryesore të këtij institucioni.

Gjatë këtij vitit kemi siguruar transparencë dhe llogaridhënie menaxheriale, kemi punuar në krijimin e kushteve në përmirësimin e shërbimeve, qasje të lehtë në shërbimet shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Synim ishte trajnimi i stafit shëndetësor, po ashtu të bëhen investime në infrastrukturë, të ofrohen kushte dinjitoze për stafin dhe pacientët dhe ngritjen e imazhit në përgjithësi të SHSKUK. Jemi munduar të ketë shfrytëzim racional të resurseve humane ku për çdo kërkesë të ketë një arsyetim, ngaqë na duhet analizë e situatës në raport me kërkesat për infrastrukturë, pajisje dhe staf shtesë.

Rritja e buxhetit të planifikuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për SHSKUK-së, nga 139,665,909.00 euro sa ishin të përcaktuar me plotësim ndryshimin e buxhetit në 157,090,004.34 euro tregon rëndësin e Qeverisë së Kosovës karshi këtij institucioni.

Bashkëpunimi dhe përkrahja nga donatorët ka ndikuar në funksionalizimin e shërbimeve të reja dhe ngritjen e numrit të shërbimeve shëndetësore në nivel të SHSKUK.

Sidoqoftë, nevoja për hapsira shtesë për punë dhe pajisje të avancuara mjekësore vazhdon të mbetet evidente. Krahas kësaj servisi dhe mirëmbajtja e rregullt e tyre është sfidë në vehte që kërkon përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm të personelit dhe kosto financiare.

Përmirësimi i ambienteve dhe kushteve të punës dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve për pacientët në institucione të ShSKUK-së, ka vazhduar me përkushtim maksimal nga menaxhmenti i ShSKUK-së.

Investimet në përmirësimin dhe zgjerimin e hapsirave të punës, ka qenë një nga objektivat, ku janë kryer investime në rinovimin e hapësirave të ndryshme si në QKUK dhe spitale të përgjithshme dhe njësit tjera. Investimi në Kuzhinen Qendrore të QKUK, Laboratorin në Spitalit të Prizrenit, ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.



Figure 1 Funksionalizimi i kabinetit të Rezonances Mganetike ne Spitalin e Pejës.

Funksionalizimin e MRI- së në Spitalin e Pejës dhe MRI- së në Spitalin e Pediatriisë dhe përgatitjes së infrastrukture për funksionalizimin e MRI- së edhe në qytete tjera në Kosovë ka për qëllim që të ofrojmë shërbime sa më afër qytetarëve.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të punës së QSHM/SHIB, në Deçan është bërë përrurimi i Shtëpisë Integruese në Bashkësi, e cila funksionon në kuadër të Qendrës së Shëndetit Mendor në Pejë. Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpive Integruese në Bashkësi, (QShM-ShIB), janë storie e suksesit, dhe do të angazhohet që të kompletohet stafi, në mënyrë që shërbimet



Figure 2 Përrurimi i Shtëpisë për Integrim në Bashkësi në Deçan

të ofrohen 24-orë. Projekti është realizuar me përkrahjen e Komunës së Deçanit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe ShSKUK-në.

Po ashtu rinovimi i hapësirave të Lavatores së Spitalit të Prizrenit do të ndikoj në kushtet më të mira higjienike në këtë institucion.

Me qëllim të arritjeve të objektivave të planifikuara Bordit Drejtues të SHSKUK-së, në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të SHSKUK, kanë vizituar Spitalet e Përgjithshëm dhe Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkesi në Kosovë.

Takimet në teren kanë pas për qëllim për të kuptuar nga afër kushtet e punës dhe trajtimin që po u bëhet pacientëve, me qëllim për rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe sigurisë gjatë ofrimit të tyre, duke pasur pacientin në qendër, mbështetur në parimin e kosto-efikasitetit të këtyre institucioneve.



Në fokus të takimeve ka qenë performanca e institucioneve, rritja e gamës së shërbimeve dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore, projektet që parashihen të zbatohen në kuadër të spitaleve, ku është premtuar gadishmëria në përkrahje për furnizim me pajisje mjekësore, përmirësimin në furnizim me produkte farmaceutike dhe material shpenzues, përkrahjen në realizimin e investimeve të planifikuara në projekte të cilat do të avancojnë shërbimet për qytetarët dhe stafin shëndetësorë në spitalet e përgjithshme dhe Reduktimit të listave të pritjes.

Nevoja për shfrytëzim racional të resurseve humane dhe furnizimi me pajisje të avancuara mjekësore vazhdon të mbetet evidente dhe është sfidë që kërkon përkushtim dhe angazhim të përgjithshëm nga institucionet e SHSKUK-së, Bordit Drejtues të SHSKUK-së dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me gjithë angazhimin maksimal Drejtoria e Përgjithshme e SHSKUK-së, ka pas sfida në realizimin e objektivave dhe aktivitetet të planifikuara. Përmirësimi dhe rritjen e besimit të qytetarëve në shërbimet e institucioneve të SHSKUK, ngritjen e gamës së shërbimeve shëndetësore, ekonomizimin e veprimeve, shpenzimi i drejtë i buxhetit të planifikuar është gjithmonë qëllim kryesor i menaxhmetit të këtij institucioni.

Po vazhdon puna në shtimin e numrit të shërbimeve shëndetësore në Klinikën e Kardiologjisë, Shërbimi i Elektrofiziologjisë dhe Elektrostimulimit, kardiokirurgji, urologji, kirurgji torakale, kirurgji të fëmijëve dhe shërbimet tjera të përkrahura edhe të ekspertëve të huaj në zgjerimin e gamës së shërbimeve.

Shoqata e Urologëve të Kosovës dhe Klinikës së Urologjisë për herë të parë në Kosovë realizuan intervenimet laparoskopike, (nefrektominë radikale dhe cystën parapielike të veshkës). Kjo u realizua falë angazhimit të profesionistëve shëndetësor të kësaj Klinike dhe në përkrahje të profesorë nga "FIRAT University", nga Turqia.

Për herë të parë, në këtë vit, është realizuar me sukses, Nefrektomia laparoskopike- "Laparoscopic Nephrectomy Ribbon Technique", në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve, nga ekipi i kirurgëve pediatrik në bashkëpunim me anesteziologët e Klinikës së Anesteziologjisë.

Intervenimi është realizuar tek një fëmijë i moshës 5 vjeçare, i diagnostikuar me veshkë jo funksionale si pasojë e hidronefrozës së gradës së katërt.

Raste të tilla sfiduese të cilat kryhen në qendra të specializuara po vazhdojnë të kryhen nga kjo klinikë, ku për mbi 4 vjet, janë realizuar intervenime laparoskopike tek fëmijët me patologji të ndryshme si: testisi intraabdominal, varikocela e testisit, divertikuli i Meckeli-it, tumoret e vezoreve, ciste e veshkës, apendektomia laparoskopike, kolecistektomia laparoskopike dhe Cista e Ekinokokut të Mëlçisë. Me avancimin e



më tërësishëm të “Kirurgjisë Minimale Invazive” do të mund të trajtohen shumica e patologjive me intervenimeve laparoskopike në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve në ShSKUK.

Shumë fëmijë me probleme të lindura të zemrës, janë operuar në Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës, me përkrahje nga Organizata "Gift of Life International Kosova", në bashkëpunim me stafin vendor të klinikave të QKUK-së, të cilët po përfitojnë eksperiencë në këtë fushë, duke shfrytëzuar praninë e ekspertëve të jashtëm.



Në mbështetje dhe koordinim të plotë me Ministrinë e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, ka nisur zbatimin e projektit të Strokut, Insultit Iskemik, i njohur në popullatë si "pika në tru". Zbatimi i projektit do të mundësojë aplikimin e trombolizës dhe tromboektomisë, procedura që largojnë mpiksjet e gjakut dhe rikanalizojnë enët e gjakut, duke i rikthyer funksionet e mëparshme tek pacienti.

Projekti ka nisur fillimisht të zbatohet në Komunën e Prishtinës, përderisa për të përforcuar njohuritë e punëtorëve të Urgjencës së kryeqytetit, mjekët e Klinikës së Neurologjisë, kanë nisur ligjerata në lidhje me këtë projekt.

Pas fillimit të projektit të trajtimit të Infarktut Akut, tashmë edhe i Strokut, me mbështetjen e plotë të Ministrisë së Shëndetësisë, e përmes së cilit do të mundësohet që shumë qytetarëve të rajonit të Prishtinës që kanë shenja të



sulmit në tru, të ju ofrohet shërbimi në kohë rekorde, në bashkëpunim me Urgjencën e qytetit të Prishtinës.

Po vazhdon me sukses të plotë ndërhyrjet dhe puna në Shërbimin e Elektrofiziologjisë dhe Elektrostimulimit në Klinikën e Kardiologjisë në QKUK.

Mjekët dhe infermierët e këtij shërbimi, po punojnë edhe gjatë vikendit duke kryer procedura të studimit elektrofiziologjik me ablacion (djegie) radiofrekuent, me teknologji konvencionale dhe sistemin bashkëkohor të mapping-ut (hartëzimit) 3 dimensional (me minimizim të rrezatimit).



Këto procedura komplekse janë kryer nga stafi i specializuar për çrregullimet e ritmit në kuadër të këtij shërbimi, nën mbikqyrjen e ekspertëve nga Qendra Klinike Universitare e Dubravës, në Zagreb-Kroaci. Puna është zhvilluar konform udhërrëfyese e rekomandimeve të Shoqatës Evropiane të Kardiologjisë (ESC) dhe Shoqatës Evropiane për Çrregullime të ritmit (EHRA)

Trajtime të njëjta janë mundur edhe falë punës bashkëpunim me ekspertët elektrofiziolog nga Bullgaria, Prof. Vassil Traykov dhe kryemjeku Dr. Valon Spahiu i cili vepron në Heilbronn, Gjermani. Elektrofiziologjia përfshin studimin e impulsit elektrik të qelizave të ndryshme, si muskujt, nervat, zemra, truri, etj.

Me përkrahjen e Profesorit dhe humanisti, Paddy Dewan, nga Australia, bashkë me ekipin e mjekëve nga Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve dhe Anesteziologjisë, kanë kryer operacione tek fëmijët që kanë anomali të lindura kirurgjike komplekse. Ky ekip ka kryer operacione dhe konsultime të shumta të fëmijë me probleme kirurgjike.



Falë bashkëpunimit të Ministris së Shëndetësisë, dhe Ambasadës së Turqisë në Kosovë dhe drejtoris së Përgjithshme të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar, mjekët nga Turqia, në bashkëpunim me stafin e mjekëve dhe infermierëve nga klinikat e QKUK-së, kanë kryer 12 operacione kardiokirurgjike tek fëmijët me probleme në zemër dhe 26 raste në sallën e

kateterizimit në kuadër të Klinikës së Kardiologjisë. Kjo u realizua në bashkëpunim dhe mbështetje të organizatës Muntada Aid, z. Kabir Miah.

Gjatë takimit me mjekët dhe stafin tjetër nga Turqia, ata kanë shprehur kënaqësinë e tyre që patën mundësi t'i trajtojnë fëmijët nga Kosova, duke shprehur falënderimin edhe për stafin vendor të klinikave që janë treguar shumë bashkëpunues.

Disa nga shërbimet të cilat më parë qytetarët detyroheshin t'i merrnin jashtë vendit, tashmë kanë filluar t'i marrin në QKUK, si rezultat i përmbushjes së objektivës së MSh për shtimin e shërbimeve të reja dhe shfrytëzimin e ekspertizës nga profesionistë që veprojnë në sistemet më të avancuara shëndetësore.



Shërbimin Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës në kuadër të grantit të ndihmës japoneze për projektet bazë të sigurisë njerëzore (GGP) për vitin fiskal 2023, vazhdojë të mbështesë Kosovën në përpjekjet e saj për të përmirësuar shërbimin shëndetësor për qytetarët e saj.



Në kohë rekorde, për dallim nga vitet e kaluara, në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, po bëhet diagnostikimi i meningjitit. Kjo u bë e mundur falë rritjes së kapaciteteve diagnostike moderne, ku tashmë rezultatet për pacientët kryhen brenda ditës.

Trajtimin i meningjiteve është kompleks dhe kërkon trajtim multi-diciplinare. Tashmë, pacientëve të dyshuar për meningjit, ju bëhet në kohë të shpejtë edhe ekzaminimet imazherike, si CT, MRI, ultrasonografia transfontaleare.

Falë një pune intensive nga Ministria e Shëndetësisë, ShSKUK, Klinika e Onkologjisë dhe Spitali i Prizrenit, për herë të parë në Spitalin e Prizrenit, ka filluar shpërndarja e terapiës tabletare onkologjike, pa pasur nevojë që pacientët të udhëtojnë në Prishtinë.

Me qëllim të përkrahjes së institucioneve shëndetësore, janë furnizuar me pajisje mjekësore dhe renovime të hapsirave për shërbime më të riorganizuara shëndetësore. Përmes këtyre ndërhyrjeve, pacientët përveç që do e kenë të lehtë, edhe do të jetë më komode.

Sigurimi i aparatit të ri për rrezatim është ka ndikuar të eliminoj lista e pritjes.

Shtimi i kapaciteteve të shtretërve dhe riorganizimi i dhënjës së shërbimeve onkologjike do plotësojë nevojat dhe cilësinë organizative të shërbimit në Klinikën Onkologjike. Me akseleratorin e ri, fokusimi i rrezeve jonizuese në inde është i sigurt për organizmin dhe përmirëson cilësinë e trajtimit me radioterapi.

Falë specifikave të akseleratorit të ri, shumë pacientë nuk do të kenë nevojë të shkojnë për trajtim jashtë vendit.

Kjo aparaturë moderne përbëhet nga një sistem i përparuar që do të shtojë numrin e pacientëve, në këtë rast fëmijëve, gjë që do të mundësojë planifikimin e më shumë ekzaminimeve.



Me investime dhe donacionet dhe angazhimin e MSh dhe ShSKUK, është duke punuar në funksionalizimin e njësishë së Mjekësisë Fetale, pjesë shumë e rëndësishme për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Ky investim do të ndikoj dukshëm në detektimin e hershëm të patologjive të ndryshme të foshnjat gjatë periudhës së shtatzënisë së nënës.

Ky program do të bëhet i mundur pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit me Zyrën Ndërlidhëse të Greqisë në Kosovë dhe Fondacionin për “Programin e Mjekësisë Fetale për periudhën 2022 – 2025”. Përgjatë kësaj kohe janë zhvilluar trajnimet praktike në baza ditore në kuadër të programit njëvjeçar në Obstetrikë – Ekografi dhe Mjekësi Fetale si subspecializim apo

profil i ngushtë. Respektivisht, janë organizuar trajnimet për rastet kur një grua ose foshnja e pa lindur mund të kërkojë kujdes të specializuar për të arritur rezultate më të mira për shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Me angazhim të MSH, dhe punës së profesionistëve shëndetësorë në kuadër të muajit të Ndërgjegjësimit për luftimin e Kancerit të Gjirit, për herë të parë shteti i Kosovës, përmes buxhetit të ShSKUK, janë siguruar mbi 100 implante dhe 50 ekspander, ku tashmë rikonstruktimi i gjirit mund të bëhet në QKUK, pa pasur nevojë që të paguhet 3 deri në 5 mijë euro në institucionet private shëndetësore.



Mbi 50 gra i është mundësuar të bëjnë rikonstruktimin e Gjirit, në QKUK. Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK, do të vazhdojnë me investime të tjera për të lehtësuar diagnostikimin dhe trajtimin e grave të prekura nga Kanceri

Ka vazhduar bashkëpunimi i SHSKUK me komandën e FSK-së, ku falë angazhimit dhe punës së institucioneve të SHSKUK, po vazhdon mbështetja me personel mjekësor përgjatë procesit të ekzaminimeve mjekësore për rekrutët e FSK-së, si dhe për gatishmërinë e pa kursyer për të mbështetur FSK-në, në ngritjen e kapaciteteve mjekësore ushtarake.



FSK dhe SHSKUK do të vazhdojnë bashkëpunimin ndërinstitucional, përmes protokolleve të cilat do të nënshkruhen në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), z. Elvir Azizi, ka vazhduar me takime të rregullta me donatorë të ndryshëm nga institucione vendore dhe atë ndërkombëtare.

Një nga takimet është aj me znj. Anke Gerrits, themeluese e Organizatës "Care For Kosovo Kids" dhe ekipin e saj nga Holanda.

Kjo Organizatë për më shumë se dhjetë vjet përkujdeset dhe siguron një sasi të barnave për

fëmijët që trajtohen në Repartin e Hemato-Onkologjisë në Klinikën e Pediatriisë. Menaxhmenti I ShSKUK-së, ka falënderuar znj. Gerrits dhe ekipin e saj për përkujdesin ndaj fëmijëve, duke çmuar tej mase edhe trajnimin e stafit mjekësor që është bërë në bashkëpunim me Qendrën Klinike Maxima në Holandë.



Takim tjetër i rëndësishëm në bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash ishte edhe takimi me profesorët nga Universiteti i Gjenevës, Dr. Besson, Dr. Kosel, Dr. Bartolemi.

Temë e diskutimit ishte gjendja e shëndetit mendor në dy shtetet dhe diskutimi i mundësisë së nënshkrimit të Memorandumit për bashkëpunim ndërmjet Kosovës dhe Universitetit të Gjenevës, për Edukimin e Vazhdueshëm të psikiatërve të Kosovës, me Klinikën Universitare në Gjenevë.



Angazhimi për bashkëpunim ka vazhduar nga Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, ku ka pritur në takim Dr. Qefsim Omaj, i cili punon si kryemjek-kardiokirurg, në Klinikën Universitare në Ulm të Gjermanisë, për të parë mundësitë e

bashkëpunimit dhe avansimit të shërbimeve të reja në Shërbimin Klinik të Kardiokirurgjisë në QKUK.

Dr. Qefsim Omaj, po realizon hapat konkret lidhur me krijimin e shërbimeve për Kardiokirurgji Minimale-invazive

moderne, respektivisht Trans-axillary Aortic Surgery.

Gjatë takimit u biseduan mundësitë që falë këtij bashkëpunimi, përmes një marrëveshje konkrete në të ardhmen, me përkrahje edhe të Ministrisë së Shëndetësisë, të fllojnë ndërhyrjet minimale-



invazive aortale dhe në implantet e zemrave artificiale. Gjatë takimi u bisedua në lidhje me trajnimin e stafit vendor i sferave kardiokirurgjike, kardiologjike dhe anesteziologjike, me synim të krijimit të shërbimeve të lartpërmendura. Tashmë, edhe kardiokirurgë nga QKUK kanë zhvilluar trajnimet e para tek Dr. Omaj për të mësuar nga afër teknikat e tilla kirurgjikale moderne. Krijimi i shërbimeve të reja të kirurgjisë së zemrës është interes shtetëror dhe do të realizohet konform standardeve bashkëkohore dhe protokoleve të Shoqatës Europiane për Kirurgji Kardio-Torakale.

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe Komuna e Prishtinës, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, kanë filluar me zbatimin e pilot projektit përmes

së cilit pacientët e rajonit të Prishtinës që pësojnë infarkt akut të miokardit do të kenë mundësi që në kohë rekorde të marrin trajtimin në kuadër të Klinikës së Kardiologjisë

Invazive, përkatësisht të sjellen direkt për koronarografi dhe stentim, pa e humbur kohën e çmuar.



Me këtë rast, drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, tha se ShSKUK, përmes Klinikës së Kardiologjisë do të mundësojë që pacientët që pësojnë infarkt të miokardit do të sjellen direkt në Kardiologji

Invazive nga Enti i Urgjencës së Komunës së Prishtinës, duke shfrytëzuar kohën që në mjekësi njihet si koha e “artë” në reagim të shpejtë.

Gjatë takimeve të mbajtur të Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK me farmacistët e ShSKUK, është kërkuar furnizim i rregullt me barna dhe materialesh shpenzues dhe shpërndarjes me kohë të ketë angazhim maksimal në realizim të detyrave dhe përgjegjësi të farmacistëve në përgjithësi.

Qëllimi i takimit ishte furnizimi me barna dhe material shpenzues, bazuar në Listën e re Esenciale të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë të japë maksimumin e punës që mos të ketë ngecje në furnizim dhe pacientëve që marrin trajtim e duhur të mos u mungojnë barnat e nevojshme.



Në takim u theksua se në rastet kur vërtetohet se ka pasur ngecje do të merren masa ligjore ndaj përgjegjësve dhe askush nuk do lejohet të jetë pengesë e proceseve të nisura.

Me qëllim të ngritjes së performancës në punë e rëndësishme ka qenë punësimi i infermierëve që do të zbusë pjesërisht mungesën e kësaj kategori e të punësuarve në disa klinika të QKUK-së.

Krejt ky angazhim dhe punë e përditëshmë kishte për qëllim arritjet e planifikuara për ngritjen e imazhit të SHSKUK-së për shërbime më cilësore dhe sa më afër qytetarëve.



1. Struktura e të punësuarve në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës

SHSKUK-së në strukturën organizative gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 kishte gjithsej 7,114 punëtorë. Sipas kualifikimeve profesionale, Mjekë specialistë janë 1,595 në përgjithësi, ku nga QKUK dhe QKSUK të anagazhuar dhe në mësimdhënie janë sipas kategoris: (63, Profesor të rregullt, 71 Asistent të rregullt dhe 31 Asistent të angazhuar) Infermier me Bachelor 1,958 apo 28%, Infermier me Shkollim të Mesëm 2,187 punëtorë apo 31%. Bashkëpunëtor profesional shëndetësor (shkollimi bazë jo i mjekësisë me profilizim-në fushën e mjekësisë) 57 punëtorë apo 0.8%. Të punësuarit si staf administrativ dhe teknik 1,233 punëtorë apo 17% dhe punëtorë të liruar pa pagesë 84 apo 1.2%.




Figura 1 Numri i të punësuarve sipas profesionit në SHSKUK




Figura 2 Të punësuarit sipas profesioneve në SHSKUK në %

2. Shërbimet e kryera sipas njësive të SHSKUK-së, Janar-Dhjetor 2023

Në periudhën Janar-Dhjetor 2023 në SHSKUK-së, janë ofruar gjithësejt **8,046,049** shërbime të ndryshme. Nga shërbimet e kryera gjatë kësaj periudhe kemi **776,185** ditë shërimi në nivel të institucioneve të SHSKUK-së, me gjithësejt **149,148** pacientë të shtrirë në 3,686 shtretër.

Nga shërbimet e realizuara gjatë kësaj periudhe janë:

- Operime 41,158
- Vizita ambulantore 1,442,984
- Vizita tjera diagnostike 738,527
- Parametra laboratorik 4,221,986 për 825,339 pacientë.
- Shërbime të ndryshme radiologjike 417,644
- Shërbime tjera apo të veçanta janë kryer 1,045,366
- Dializa janë kryer 120,704 dializa.
- Lindje janë kryer gjithësejt 17,710 dhe kemi 18.001 femjë të lindur. Nga këto lindje me operim janë kryer 6,671 apo 38% e lindjeve.

Mesatarja e ditëve të shërimit për pacient në nivel të SHSKUK gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 është 5.2 ditë, ndërsa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve të ShSKUK-së është 58%.

Shërbimet e kryera sipas njësive të SHSKUK.

- ❖ **Qendrën Klinike Universitare e Kosovës**, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë realizuar gjithësejt 3,715,986 shërbime. Në 1,722 shtretër të deklaruar kanë qenë 441,319 ditë shërimi nga 73,135 pacientë të shtrirë. Nga pacientët e shtrirë janë operuara 23,204 pacientë, po ashtu janë ofruar 480,868 vizita ambulantore, ndërsa vizita diagnostike janë kryer 474,772. Gjatë kësaj periudhe janë kryer 163,297 shërbime imazherike-radiologjike, kurse parametrat laboratorik 2,116,106 për 419,253. Janë realizuar 37,579 dializa për pacientë dhe janë kryer 7,723 lindje, nga ky numër i lindje 2,971 raste janë realizuar me operim apo 38% dhe janë lindur 7,926 fëmijë dhe shërbime tjera apo të veçanta janë kryer 412,437.

Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve është 70% ndërsa mesatarja e ditëve të shërimit të pacientëve në QKUK është 6 ditë.


- ❖ **Spitalet e Përgjithshme**, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë realizuar gjithësejt 3,563,529 shërbime. Me 1,904 shtretër, ditë shërimi kishte 312,428 nga 75,951 pacientë të shtrirë. Nga këta pacientë të shtrirë janë operuar 17,954 pacientë. Janë realizuar 839,718 vizita ambulantore, vizita tjera diagnostike 193,384 dhe shërbime tjera apo të veçanta 168,053. Po ashtu në këto njësi janë kryer 2,001,441 parametra laboratorik për 398,620 pacientë. Shërbime imazherike- radiologjike janë kryer gjithësejt 249,867 shërbime, janë realizuar 83,125 dializa dhe janë kryer 9,987 lindje, ku nga këto lindje 3,700 janë kryer me operim apo 37% dhe janë lindur 10,075 fëmijë.

Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve në spitale të përgjithshme është 45% kurse mesatarja e ditëve të shërimit është 4.1 për ditë.

- ❖ **Qendren Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës- QKSUK**, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë kryer gjithësejt 441,759 shërbime stomatologjike. Vizita ambullantore-vizita e parë/ Vizita kontrolluese janë kryer 66,031, Vizita tjera diagnostike 12,870, Shërbime tjera të veçanta janë realizuara gjithësejt 362,858.
- ❖ **Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës-QKTK**, janë ofruar trajnime profesionale dhe telekonferenca, publikime shkencore, për 10,471 staf mjekësor (mjekë specialistë, infermierë, specializant dhe të tjerë). Nga këta staf mjekësor 5,356, Studentë 5,114 dhe 1 profesioneve tjera.
- ❖ **Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës-QKMP** në Gjakovë gjatë kësaj periudhe janë kryer gjithësejt 174,713 shërbime. Nga shërbimet e kryera janë 27,899 vizita ambulantore, 33,652 vizita tjera diagnostike, shërbime laboratorike janë kryer 104,439 parametra për 7,466 pacientë dhe 4,243 shërbime tjera. Gjithashtu në këtë njësi janë kryer 4,480 shërbime radiologjike-imazherike.
- ❖ **Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive- QKMS**, janë kryer gjithësejt 18,457 shërbime. Nga këto shërbime të kryera janë: Vizita Ambulantore 60, Seanca –terapi fizikale 159, referime specialistike 741 dhe kontrolla sistematike 17,497, sipas kategorive Sportista 16,723, Referë 583 dhe sport Individual 191 .
- ❖ **Qendrat e Shëndeti Mendor me Shtëpit për Intergrim në Bashkësi dhe QIRSKP-Shtime**, me 8 njësi në të gjithë Kosovën, janë kryer gjithësejt 121,134 shërbime të ndryshme, nga këto shërbime i kemi 28,408 vizita psikiatrike-psikologu- si vizita ambulantore, po ashtu vizita shtëpiake janë kryer 6,352 si vizita tjera diagnostike, ndërsa terapi okupuese art, sporte, argëtim, dhe shërbime të punëtorit social 86,374 si shërbime të veçanta. Në QIRSKP-Shtime gjatë kësaj periudhe kishte 62 pacientë të shtrirë me 22,438 ditë shërimi.

3. Performanca e punës në SHSKUK-së Janar-Dhjetor 2023

Performanca e punës në SHSKUK Janar-Dhjetor 2023



3.1. Numri i pacientëve dhe ditët e shërimit sipas njësive në SHSKUK, Janar-Dhjetor 2023.

Bazuar në të dhenat në nivel të SHSKUK-së, kanë qenë të shtrirë gjithësejt 149,148 pacientë me 776,185 ditë shërimi në 3,686 shtretër. Në përgjithësi në QKUK kanë qenë të shtrirë 73,135 me 441,319 ditë shërimi në 1,722 shtretër. Në spitale të përgjithshme ishin 75,951 pacientë të shtrirë me 312,428 ditë shërimi dhe në QSHM-SHIB- QIRSKP-Shtime ishin 62 pacientë të shtrirë me 22,438 ditë shërimi.




Figura 4 Numri i pacienteve dhe ditët e shërimit sipas njësive 2023

Nëse e krasojmë me vitin 2022 gjatë këtij vitit kemi zvoglim të numrit të pacientëve të shtrirë për 3,217 pacientë më pakë apo -2% dhe ditë shërimi kemi rritje prej 5,233 ditë me shumë apo 1% edhe për kundër zvoglimit të numrit të shtretërve prej -119 apo -3%.

3.2. Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të shërimit në ShSKUK, Janar-Dhjetor 2023

Sipas njësive të të SHSKUK-së, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2023, mesatarja e ditëve të shërimit për pacientë është 5.2 ditë dhe shfrytëzueshmëria 58%.




Figura 5 Kohëzgjatja mesatare e shërimit dhe shfrytëzueshmëria e kapaciteteve 2023

Në QKUK kemi 70% të shfrytëzueshmërisë së kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të shërimit për një pacientë është 6.0 ditë, në spitale të përgjithshme kemi 45% të shfrytëzimit të kapaciteteve të shtretërve dhe mesatarja e ditëve të shërimit është 4.1 ditë dhe njësit tjerë konkretisht QIRSKP-Shtime kemi 102% të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të shërimit është 362 ditë për pacientë.

3.3. Krahasoni i shërbimeve të kryera në SHSKUK-së sipas viteve 2022-2023

Sipas të dhënave në krahasim me vitin 2022 ku kishte 7,737,599 shërbime në përgjithësi, ndërsa në periudhën Janar-Dhjetor 2023 në SHSKUK-së, janë ofruar gjithsej 8,046,049 shërbime të ndryshme, nëse krahasojmë me periudhën e njëjtë të viti të kaluar kemi një ngritje të shërbimeve në përgjithësi për 308,450 apo të shprehura në përqindje me 4% më shumë shërbime.

Edhe për kundër se në vitin 2022 kishim të shfrytëzuar 3,805 shtretër në vitin 2023 kemi 3,686 shtretër apo -119 shtretër më pakë se në vitin 2022. Ky ndryshim po ndodh nga menaxhmenti njësisë për riorganizim të shërbimeve dhe rënvimeve të ndryshimeve brenda hapsiurave të njësisë.

Gjatë vitit 2022 kishim 770,952 ditë shërimi kurse në vitin 2023 kemi 776,185 për qka kemi + 5,233 ditë shërimi më shumë apo 1% se në vitin 2022. Rritja e ditëve të shërimit në krahasim me vitin paraprak është kundër planifikimeve të objektivave të përcaktuara në uljen e ditëve të shërimit për pacientë. Pra sipas të dhënave të përgjithshme në vitin 2022 mesatarja e ditëve të shërimit ishte 5.1 ndërsa në vitin 2023 mesatarja e ditëve të shërimit për pacientë është 5.2, pra kemi një rritje për 0.1 ditë.

Ndërsa numri i pacientëve të shtrirë në vitin 2022 ishte 152,365 kurse në vitin 2023 kishte 149,148 pacientë, ku kemi -3,217 pacientë më pak apo 2% se vitin paraprak. Edhe kundër zvoglimit të numrit të pacientëve të shtrirë kemi rritje të ditëve të shërimit, ndryshim në uljen e pacientëve të shtrirë për marrjen e shërbimeve në njësit të SHSKUK mund të jetë nga faktorë të ndryshëm për çka duhet të vlerësohet cilët faktor kanë ndikuar në uljen e numrit të pacientëve për shtruar në institucionet e SHSKUK.

Numri i operimeve të kryera branda institucioneve të SHSKUK për vitin 2023 ka pas një rritje prej 414 raste apo 1% më shumë se në vitin 2022. Po ashtu edhe tek vizitat ambulatore nëse krahasojmë me vitin 2022 ku kishte 1,429,546 vizita në vitin 2023 janë realizuar 1,442,984 vizita apo 13,438 më shumë apo 1%. Gjithashtu edhe tek vizitat diagnostike kemi një rritje të kësaj kategorie të shërbimeve të realizuara në SHSKUK me 120,290 raste më shumë apo 19%.

Krahasimi i shërbimeve në SHSKUK Janar-Dhjetor 2022/2023																	
	Nr i Shtretërve	Ditë shërimi	Nr. i pacientëve të shtrirë	Nr. i operuarve	Vizita ambulantore	Vizita tjera tjera diagnostike	Shërbime laboratorike	Nr. i Dializa	Shërbime tjera/apo te vecanta	Shërbime Radiologjike	Nr. i Lindje	Shfr i kapacitet eve	Mesatarja e diteve te Sherimit	Total Shërbime Janar-Dhjetor	Numri i fëmijëve të lindur	Numri i lindjeve me operim	%Lindjev e me Op
Total shërbime SHSKUK 2022	3,805	770,952	152,365	40,744	1,429,546	618,237	3,990,411	118,095	1,142,130	379,189	19,247	56%	5.1	7,737,599	19,482	6,774	35%
Total shërbime 2023	3,686	776,185	149,148	41,158	1,442,984	738,527	4,221,986	120,704	1,045,336	417,644	17,710	58%	5.2	8,046,049	18,001	6,671	38%
Dallimi i nr. Shërb. 2023-2022	(119)	5,233	(3,217)	414	13,438	120,290	231,575	2,609	(96,794)	38,455	(1,537)	2%	0.1	308,450	(1,481)	(103)	3%
Dallimi në %. Shërb. 2023/2022	-3%	1%	-2%	1%	1%	19%	6%	2%	-8%	10%	-8%	2%	0.5%	4.0%	-8%	-2%	3%

Tabela 1 Krahasimi i shërbimeve të realizuara në SHSKUK, sipas kategorive dhe viteve 2022/2023

Shërbimet– laboratorike, parametra të realizura në vitin 2023 kemi rritje të numrit të parametrave për 231,575 apo 6% më shumë se në vitin 2022. Po ashtu edhe shërbime të dializës ka pas një rritje të numrit të dializave të kryera për 2,609 raste më shumë apo 2%.

Kurse shërbime tjera apo të veqanta ka pas një ultje të shërbimeve të kryera, ne vitin 2022 janë kryerj 1,142,130 kurse në vitin 2023 janë ofruar 1,045,366, sipas të dhënave kemi -96,764 shërbime më pak apo -8%.

Shërbime imazherike-radiologjike kemi rritje të numrit të shërbimeve për 38,455 apo 10% më shumë. Kjo rritje ka ndodh për shkak të funksionalizimit të pajisjeve të reja si MRI në Spitalin e Pejës, MRI në Spitalin Pediatrik në QKUK, pajisje tjera që kanë hy në funksion gjatë këtij viti dhe rritjes së vëllimit të punëve me qëllim të uljes së listave të pritjes.


Ndërsa sa i përketë lindjeve të realizuara në njësit e SHSKUK në vitin 2022 kishte 19,247 lindje ndërsa në vitin 2023 janë kryer 17,710. Sipas të dhënave kemi ulje të numrit të lindjeve -1,537 lindje më pak se viti paraprak apo -8%. Nga lindjet e kryera në vitin 2022, 35% e lindjeve kanë qenë me ndërhyrje kirurgjike apo SC. Në krahasim me vitin 2023 numri i lindjeve me operim është 6,671 lindje apo 38% e rasteve, pra kemi rritje të lindjeve me operim për 3%.

Për shkak të uljes së numrit të lindjeve edhe numëri i fëmijëve të lindur është zbritur për - 1,481 fëmijë më pak apo -8%.

Pra në përgjithësi është rritë shfrytëzueshmëria e kapaciteteve nga 56% që ishte në vitin 2022 ne vitin 2023 është 58%, pra kemi rritje për 2% të shfrytëzueshmëris së kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të qëndrimit është rrit nga 5.1 sa ishte në vitin 2022, kurse në vitin 2023 është 5.2 ditë për pacientë.

3.4. Krahasoni i shfrytëzueshmërisë së kapaciteteve dhe ditëve të shërimit në QKUK dhe Spitale 2022/2023

Nëse krahasojmë shfrytëzueshmërisë e shtretërve dhe ditëve të shërimit në QKUK dhe spitale të përgjithshme nga viti 2022/ 2023, në QKUK në vitin 2022 ishte 67% ndërsa në vitin 2023 është 70% pra kemi një rritje prej 3% të shfrytëzueshmërisë. Ndërsa mesatarja e ditëve të shërimit në



2022 ishte 5.7 ditë për një pacientë kurse në vitin 2023 kemi 6.0 ditë, pra kemi një rritje prej 0.3 ditë më shumë për pacientë edhe për kundërs numrit më të ulët të pacientëve të shtruar, për çka kërkon vlerësim të kësaj gjendje.

Në spitale të përgjithshme në vitin 2022 ishte shfrytëzueshmëria e kapaciteteve 43% ndërsa në vitin 2023 është rrit në 45%,

Figura 6 Krahasoni i shfrytëzueshmërisë së kapaciteteve dhe ditëve të shërimit sipas vitit 2022/2023

kjo rritje mundë ta vlerësojmë pozitive pasi kemi kërkesë në rritjen e numrit të pacientëve që marrin shërbime shëndetësore në institucione publike. Ndërsa mesatarja e ditëve të shërimit ka mbetur e njëjtë 4.1 ditë me vitin 2022 me atë 2023.

3.5. Krahasoni i numrit të shtretërve dhe numri i pacientëve të shtrirë sipas njësive 2022/2023

Sipas të dhënave nëse krahasojmë këto të dhëna për vitin 2022 me 2023, në QKUK kemi -4,480 pacientë më pakë apo - 6%, po ashtu edhe numri i shtretërve gjatë këtij vitit është raportuar për 85 shtretër më pak apo -5% se viti i kaluar.

Në spitale të përgjithshme është rrit numri i pacientëve të shtrirë për 1,265 pacientë apo 2% më shumë, kurse numri i shtretërve ishte për 29 më i vogël se vitin 2022. Kurse në QIRSKP në Shtime kemi ulje të numrit të pacientëve të shtrirë për -2 pacientë apo -3% dhe numri i shtretërve ishte më pak se në vitin paraprak -5 shtretër apo -8%.




Figura 7 Krahasoni nr. Te shtretërve dhe pacienteve të shtrirë sipas njësive dhe viteve

4. Struktura e të punësuarve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës QKUK

Në listën e të punësuarve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës janë gjithsejt 3,344 punonjës. Sipas strukturës profesionale nga ky numër i të punësuarve kemi: Mjekë Specialist në përgjithësi 812 apo 24% nga numri i përgjithshëm i stafit. Nga këta mjekë specialist të angazhuar dhe në mësimdhënie sipas kategoris janë (Profesor të rregullt janë 51, Asistent të rregullt 58 dhe Asistent të angazhuar 27)

Infermierë me Bachelor 1,238 apo 37%, Infermierë me shkol të mesme 779 apo 23%. Bashkëpunëtorë profesional (shkollimi bazë jo i mjekësisë me profilizim në fushën e mjekësisë) 18 punëtorë apo

1%, të punësuar si staf administrativ dhe teknik 452 apo 14% dhe të punësuar të liruar pa pagesë 45 punëtorë apo 1%.




Figura 8 Numri i të punësuarëve në QKUK sipas profesionit




Figura 9 të punësuarve sipas profesionit në % në QKUK

5. Shërbimet e përgjithshme të kryera në QKUK-së, Janar-Dhjetor 2023

Në periudhës Janar-Dhjetor 2023 në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në 1,722 shtretër ishin 73,135 pacientë të shtrirë me 441,319 ditë shërimi. Nga pacientët e shtrirë janë operuar 23,204 pacientë, dhe janë ofruar 480,868 vizita ambulantore dhe 474,772 vizita tjera diagnostike. Nga shërbimet radiologjike apo imazherike janë ofruar 163,297, gjithashtu janë kryer 2,116,106 parametra laboratorik për 419,253 pacientë dhe shërbime tjera po të veqanta janë kryer 412,437 shërbime. Gjithashtu janë kryer 37,579 shërbime të dializës. Po ashtu janë kryer lindjet e kryera në QKUK ku kemi 7,723 lindje.

Mesatarja e ditëve të shërimit për pacientë gjatë kësaj periudhe ishte 6.0 ditë, kurse shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve në QKUK është 70%

Në KOGJ janë kryer 7,723 lindje, nga këto lindje 2,971 janë kryer më operim apo të shprehura në përqindje 38% dhe kemi 7,926 fëmijë të lindur.

Në Klinikën e Radiologjisë dhe Mjekësin Nukleare janë kryer gjithësejt 163,297 shërbime të ndryshme diagnostike- radiologjike si: (MRI, CT, Ultrazë, Radiografi, Angjiografi, Mamografi, Sintigrafi të pjesë të nryshme trupore, Densitometri të kockave dhe shërbime tjera radiologjike).

Shërbime të dializës janë kryer gjithësejt 37,579, në klinikën e Nefrologjisë janë kryer gjithësejt 37,431 shërbime të dializës, dhe Klinikën e Pediatriisë janë kryer 148 dializa.

Në Klinikën e Kardiologjisë janë kryer 4,052 koronografi, nga këto konarografi kemi 2,561 stent procedura, ndërsa janë vendosur 3,535 stenta dhe 142 Pejsmeker të përhershëm.

Në Klinikën e Kardiokirurgjisë janë kryer 320 operacione kardiokirurgjike.

Në Klinikën e Anestezionit dhe Reanimacionit janë 19,630 anestezone nëpër klinika të ndryshme.

Në Klinikën e Onkologjisë kanë qenë të shtrirë 846 pacientë me 3,779 ditë shërimi dhe 53,352 vizita ambulantore. Po ashtu janë dhënë 37,824 terapi me citostatik dhe raste të reja me sëmundje malinje janë paraqit 2,127 raste.

6. Performanca e punës në Qendren Klinike Universitar të Kosovës Janar-Dhjetor 2023




Figura 10 Shërbimet e kryera në QKUK 2023

7. Shërbimet shëndetësore të ofruara sipas klinikave në QKUK -Janar-Dhjetor 2023

Nr	Njësit	Nr i Shtretërve	Ditë shërimi	Nr. të shtrirëve	Nr.të operuarve	Vizita ambulantore	Vizita tjera diagnostike	Shërbime radiologjike	Shërbime laboratorike	Dializa	Lindje	Shërbime tjera/apo te vecanta	Shfr i kapacitet eve	Sherimi
1	Klinika Obstetrike Gjinekologjike	301	65,498	14,752	4,233	2,134	82,490				7,723	53,984	60%	4.4
2	Klinika e Kirurgjisë Abdominale	69	15,972	3,034	2,254	4,934	11,421					11,318	63%	5.3
3	Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	21	6,841	702	1,066	4,073						2,190	89%	9.7
4	Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë	103	17,555	2,280	1,950	27,677	1,281					7,882	47%	7.7
5	Klinika e Kirurgjisë Torakale	24	7,406	972	545	3,932	642					1,445	85%	7.6
6	Klinika e Syve	58	16,161	3,555	4,299	44,721	3,057					4,993	76%	4.5
7	Klinika e ORL-së	64	17,148	1,985	2,014	9,566	21,313					3,651	73%	8.6
8	Klinika e Kirurgjisë Plastike	21	5,154	894	2,160	9,778						12,073	67%	5.8
9	Klinika e Neurokirurgjisë	24	6,531	957	738	4,328	1,988					2,398	75%	6.8
10	Klinika e Urologjisë	23	6,067	1,376	1,057	7,630	12,373					3,776	72%	4.4
11	Klinika e Kardiokirurgjisë	14	5,067	402	320	402	8,799					4,224	99%	12.6
12	Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	20	3,815	1,958	1,324	3,645	2,232					6,886	52%	1.9
13	Klinika Kirurgji Vaskulare	24	6,548	1,467	1,244	8,841	2,579					4,155	75%	4.5
14	Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimi Intensiv	29	9,469	909		78,870						34,362	89%	10.4
15	Klinika e Gastroenterologjisë	33	8,967	1,087	-	7,571	5,902					9,168	74%	8.2
16	Klinika e Hematologjisë	20	5,407	567	-	5,138	3,590					4,921	74%	9.5
17	Klinika e Dermatovenerologjisë	30	7,500	964		22,836	3,331					12,566	68%	7.8
18	Klinika e Alergologjisë me Imunologji	11	1,981	448	-	3,204	1,642					2,142	49%	4.4
19	Klinika Infektive	120	28,752	2,787	-	16,073	3,961					9,624	66%	10.3
20	Klinika e Nefrologjisë	18	5,259	758		4,242	9,281			37,431		9,536	80%	6.9
21	Klinika e Pulmologjisë	66	23,191	1,803		15,495	10,910					6,217	96%	12.9
22	Klinika e Kardiologjisë	75	28,013	7,630		17,445	36,021					13,014	102%	3.7
23	Klinika e Endokrinologjisë	32	7,429	773	-	15,475	31,693					3813	64%	9.6
24	Klinika e Reumatologjisë	27	8,009	1,460	-	8,560	4,760					241	81%	5.5
Ne Klinikën e Ortopedisë lista e Dg. Proteza totale te gjunjeve, Proteza totale te kerdhokullave, Ruptura e menisqeve dhe ACL, Anomalit kongjenitale te femijeve, Stabilizimet ne shtyllen kurrizore etj. Kirurgjia Plastike; Lezionet e tetivave, Tumoret beninje të lëkurës, Tumoret malinje të lëkurës, Sëmundjet degenerative të shuplakës, Komplikacionet e djegieve-kontrakturat, cikatrikset hipertropike, Lëndimet e ekstremiteteve të sipërme, Lëndimet e ekstremiteteve të poshtme, Defektet lëkurore, Dekubitet, Rekonstruksioni i gjirit, Anomalit kongjonitale të ekstremiteteve dhe Hipertrofia e gjirit.

Klinika e Syve me Dg. Katarakta, Strabizmi, Ptoza, Dakryocistitet, Tumorët, PPV, Glaukoma, Keratoconus për XCL, Pterygium dhe Ektropium, Kirurgjia Torakale, Biopsi e gjirit, Biopsi e murit torakal, Gynecomastia, Struma nodosis gl thyroidea, Hypertrofia mammae.

Klinika e ORL, 1. Tonsilloadenoidectomy, 2. Deviatio septi nasi, 3. FESS, 4. Struma nodosa –jo tumorale, 5. Mastoidectomy jo urgjente, 6. Otitis secretor-paracentesis me instilim të gypave aerizues, 7. Timpanoplastikat, dhe 8. Patologjitë beninje të laringut.

Në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale këto diagnoza figurojnë në lista të pritjes: Cholelithiasis – Laparoskopji, Cholelithiasis - me Laparotomi, Hernia inguinalis, Hernia umbilicalis, Cysta pylonidalis, Fistula perianalis, Sinus pilonidalis, Hernia ventralis, Cysta hydatidosa loby dex hepatis, Granulomae et fistulae perianalis, Dolichosigma, Hernia parietis abdominis, Hernia epigastrica, Noduli Hemorrhoidalis dhe Hernia incisional.

Kirurgjia e Fëmijëve ka këto diagnoza në lista të pritjes: Hernia inguinalis, Retentio testis, Hydrocoella testis. Klinikën e Neurokirurgji- Hernia discii, Cranioplastica, Leasio nervi, dhe Sy. Tunelis carpal. Në Klinikën e Urologjisë në listat e pritjes janë këto patologji: PTV, Orchiectomy radicalis, Hydrocolectomy, TOT, Cystoectomy, Extirpation of cysts, Extirpation of caruncles, TUR leukoplakia, TUR Tuv.urin. Cystolithotripsy, TUR-P, Nephrolithotomy, Lig. v.spermatika, Orchidopexy, Pyeloplasty, Urethrotomy int. Nephrectomy, URS-lithotripsy, Cystectomy radicali, dhe Prostatectomy radicalis.

Arsyet më të shumta për lista të pritjes janë: mungesa e hapsirave të nevojshme, aparatura dhe pajisjet mjekësore, përgaditja profesionale dhe mungesa e stafit.

Kurse në Spitalet Regjionale kemi disa nga shërbimet të cilat janë në lista të pritjes si: Spitalin Gjakovë: CT dhe Operimi i cataractës, Spitali Mitrovicë: CT, diagnostika, Momografia, Echo, Abdomeni, Kolonoskopia, FAKO intervenimi/oftalmo. Në Spitali Prizren: CT, Kirurgji, EEG, Biopsi, Citologji, PAP test, Spitali Ferizaj; Operimet e kirurgjise se pergjithshme, Operimet urologjike, Operime ORL, Emergjencat dhe rastet me prioritet, Ultrazeri qafe, Ultrazeri gjirit post op Ca, Ultrazeri gjirit ambullantor, Eko e abdomenit rastet ambullantore. Në Spitali Gjilan janë: ORL, CT. Ndërsa në Spitalin e Pejës janë: Cholelithiasis, Lypoma, Sinus pylonidalis, Sinus pylonidalis, Cholelithiasis etj, të gjitha pritjet janë me afata deri me tri javë.

18. Referimet për trajtimi mjekësore të pacientëve jashtë institucioneve të SHSKUK

Në bazë të raporteve nga institucionet e SHSKUK sa i përket numrit të referimeve për trajtim jashtë institucioneve publike kemi 1,144 pacientë gjithësej. Nga 38 njësi të QKUK, kanë raportuar se kanë referuar trajtim të pacientëve jashtë institucioneve publike 26 njësi apo 71% e tyre.



Figure 35 Numri i referimeve sipas njësive 2023

Sipas të dhënave me numër më të madh të referimeve prinë Shërbimi i Mjekësisë Nukleare me 311 apcientë apo 27% e numrit të referuave. Arsyt kryesore të referimeve është mungesa e aparatit të PET-CT. Pastaj me referime vjen Klinika e Pediatriisë me 180 raste apo 16%, për trajtime të ndryshme pediatrike, Klinika e Hematologjisë me 126 raste apo 11%, Klinika e Ortopedisë dhe

Traumatologjisë me 85 raste apo 7% e rasteve të referuara, Klinika e Nefrologjisë ka 70 referime për trajtim jashtë institucioneve publike apo 6% e rasteve. Arsyeja është mungesa e stafit profesional dhe Legjislacionit aktual në fuqi. Pasta vjen klinika e Radiologjisë me 66 raste të referimeve apo 6%, Klinika e ORL-së, 63 raste apo 6%, Klinika e Urologjisë me 32 raste apo 3%. Klinika e Kirurgjisë Vaskulare ka 23 referime apo 2%, Klinika e Neonatologjisë me 21 raste apo 2%, Klinika e Neurologjisë me 19 raste apo 2%, Klinika e Gastroenterologjisë me 16 raste apo 1%, Kirurgjia Plastike 15 raste, Kirurgjia Torakale 14 raste të referimeve, Klinika e Onkologjisë 12 raste, Klinika e Kardiologjisë 10 raste të referimeve, Klinika e Kardiokirurgjisë, 10 raste, Klinika e Pulmologjisë 9 raste, Klinika e Kirurgjisë Abdominale 5 raste, Klinika Obstetrike Gjinekologjike 3 raste, Klinika e Dermatovenerologjisë 2 raste, Klinika e Kirurgjisë së fëmijëve 2 raste dhe Klinika e Kirurgjisë Maxillofaciale 2 raste. Disa nga njësit kanë mospërditësim të të dhënave në lidhje me referimet e pacientëve për trajtim jashtë institucioneve publike në nivel të SHSKUK-së.

19. Disa nga shkaqet dhe arsyet e mos ofrimit të shërbimeve në institucioneve publike

Bazuar nga raportet e klinikave të QKUK, për referim të pacientëve për kryerjen e trajtimeve jashtë institucioneve publike arsyet janë të ndryshme po disa me kryesore janë:

Nga të dhënat për referime të pacientëve janë paraqit disa nga arsyet për referime. Arsyet janë: Nga 24 njësi që kanë referuar për referime të pacientëve 12 nga to apo 39% kanë deklaruar për mungesë të aparaturës dhe hapsirave. Kurse 11 njësi apo 35% e njësive referuese janë arsyetuar për mungesë të stafit të kualifikuar. Kurse arsyet tjera janë mungesa e Mjekëve Specialist, Mungesa e reagensave për vertetimin e diagnozave gjenetike, Mungesa e trajtimit kardiokirurgjik në vendin tone, trajtim multidisciplinar dhe qendrat e specializuara, për shkak të trajtimit permanent, Mungesa e legjislacionit, mungesa e aparaturës së PET/CT-së.

Me qëllim të uljes së referimeve jashtë institucioneve publike është e rëndësishme trajnimi i stafit mjekësorë jashtë vendit dhe edukimi i vazhdueshëm profesional, sigurimin e pajisjeve mjekësore, krijimi i hapsirave për punë dhe riorganizim i disa nga institucioneve.




Figure 36 Disa nga arsyet e referimeve të pacientëve jashtë institucioneve publike

20. Frunizimi me produkte farmaceutike dhe material shpenzues sipas planifikimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023

Në kuadër të furnizimit të qëndrueshëm me produkte medicinale dhe material medicinal, Lista Esenciale e barnave përmban gjithsej 884 produkte medicinale prej të cilave për vitin 2023 kanë qenë të planifikuara nga njësitë kërkuuese të ShSKUK-së gjithsej 497 produkte medicinale dhe 429 materiale medicinale nga Lista Esenciale.

Kontrata aktive gjatë vitit 2023 me produkte medicinale kanë qenë 251 apo të shprehura në përqindje 51% dhe materiale medicinale 240 produkte apo 56%. Produktet medicinale me rëndësi vitale të cilat nuk janë të kontraktuara për shkak të mungesës së çertifikatës së Autorizim Marketingut-AM, janë rreth 5%. Kurse rreth 265 produkte medicinale janë nën vlerën 2,000 euro për të cilën e vështirëson kontraktimin e tyre për shkak të sasisë dhe vlerës së ulët. Gjithashtu janë 144 produkte medicinale apo 29% të cilat nuk janë kontraktuar për shkak të deshtimit në procedura të prokurimit. (kryesisht produkte pa AM).

Sipas të dhënave të përgjithshme ShSKUK ka qenë e furnizuar me produkte farmaceutike dhe material shpenzues sipas planifikimit nga Lista Esenciale 53% me Barna ndërsa me Material shpenzues 67%

Përqindja e furnizimi Janar-Dhjetor 2023 sipas			
Nr	Institucioni	Produkte farmaceutike	Material shpenzues
1	QKUK	56%	55%
2	SP-Prizren	50%	58%
3	SP-Gjakove	45%	61%
4	SP-Peje	47%	56%
5	SP-Gjilane	50%	53%
6	SP-Ferizaj	40%	52%
7	SP-Mitrovice	38%	61%
8	SP-Vushtrri	61%	63%
9	QSHM Prishtine	69%	88%
10	QSHM Prizren	74%	75%
11	QSHM Gjakove	57%	67%
12	QSHM Peje	56%	81%
13	QSHM Gjilane	51%	87%
14	QSHM Ferizaj	64%	93%
15	QSHM Mitrovice	50%	60%
16	QIRSKP Shite	44%	55%

Table 18 furnizimi i njësive të ShSKUK me barna dhe material shpenzues në %

- Në QKUK sipas planifikimit për produkte farmaceutike është furnizuar 56% ndërsa me material shpenzues 55%,
 - Spitali i Përgjithshëm në Prizren, është furnizuar me produkte farmaceutike 50% ndërsa me material shpenzues 58%.
 - Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë furnizim me produkte farmaceutike kemi 45%, ndërsa me material shpenzues është furnizuar 56%.
 - Spitali i Përgjithshëm Pejë, sipas planifikimit për furnizim me produkte farmaceutike kemi 47%, ndërsa me material shpenzues është furnizuar 56%.
 - Spitali i Përgjithshëm në Gjilane, ka pas furnizim me produkte farmaceutike 50%, ndërsa material shpenzues 53% sipas planifikimit.
 - Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, ka pas furnizim me produkte farmaceutike 40% ndërsa me material shpenzues 52%.
- Spitali në Mitrovicë është furnizuar me produkte farmaceutike 38 % ndërsa me material shpenzues 61%.

- Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri me produkte farmaceutike ka qenë e funizuar 61% ndërsa me material hargjues 63% sipas planifikimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023.
- Ndërsa QSHM/SHIB Prishtinë është furnizuar me produkte farmaceutike 69 % ndërsa me material shpenzues 88%.
- QSHM/SHIB Prizren është furnizuar me produkte farmaceutike 74 % ndërsa me material shpenzues 75%.
- QSHM/SHIB në Gjakovë është furnizuar me produkte farmaceutike 57 % ndërsa me material shpenzues 67%.
- QSHM/SHIB në Pejë, është furnizuar me produkte farmaceutike 56 % ndërsa me material shpenzues 81%.
- QSHM/SHIB Gjilanë është furnizuar me produkte farmaceutike 51 % ndërsa me material shpenzues 87%.
- QSHM/SHIB Ferizaj është furnizuar me produkte farmaceutike 64 % ndërsa me material shpenzues 93% dhe
- QIRSKP-Shtime është furnizuar me produkte farmaceutike 44 % ndërsa me material shpenzues 55%.

Furnizimi jo i knaqshëm sipas planifikimit po paraqitet për shkak të legjislacionet aktuale në fuqi, organit shqyrtuese të prokurimit, mungesa e shumë barnave që nuk janë në tregun e Kosovës, produkteve që nuk kanë Autorizim Marketingu, interesi nga OE për shkak të sasive të vogla nuk konkurojn fare, vonesave në liferime për shkak të transportit etj.

21. Donacionet e pranuar në SHSKUK-së, Janar-Dhjetor 2023

Gjatë kësaj periudhe ShSKUK-së ka pranuar donacione nga shumë donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë, si pajisje mjekësore, produkte mjekësore dhe materiale të tjera. Këto donacione ka ndikuar në përmirësimin dhe numrin e shërbimeve.

Donacionet Janar- Dhjetor 2023		
Lloji	Numeri i donacioneve	Vlera e donacioneve
Pajisje mjekësore	9,947	553,918.40
Produkte mjekësore	374,916	3,928,620.73
Të tjera	39,395	983,356.20
Total	424,258	5,465,895.62

Gjatë kësaj periudhe, SHSKUK-së ka pranuar gjithësej 424,258 pajisje e produkte mjekësore dhe material të ndryshëm nga 132 donatorë me vlerë të përgjithshme prej 5,465,895.62 Euro.

Donacionet e pranuar në SHSKUK-së, përfshin gjithësejt 9,947 pajisje mjekësore mjekësore, me vlerë 553,918.40 euro. Produkte mjekësore gjithësejt 374,916 copë me vlerë 3,928,620.73 euro dhe materiale të tjera janë 39,395 copë me vlerë 983,356.20 euroa që në total numri i donacioneve është 424,258 kanë vlerën prej 5,465,895.62 euro nga 132 donatorë të ndryshëm.

Sipas të dhënave në vitin 2023 kemi me shume donatorë se në vitin 2022 për 24 donatorë më




Figure 37, Numri i donatorëve, numri i donacioneve dhe vlera e Donacionet e pranuaras 2022/2023

shumë apo 18%, edhe numri i donacioneve është më i madhe për 202,628 apo 48%, po nga vlera e përgjithshme e donacioneve është më e vogël (935,363.39€) apo - 17% më e vogël vlera se në vitin 2022.

Disa nga institucionet që kontribuan me donacione janë: Hoffmann - La Roche Ltd, OJQ Pema, Asgeto, Santefarm, UNFPA, Kryqi i Kuq i Kosoves - Ambasada e Belgjikes,

NTP Butterfly, Asgeto, KEIS, Santefarm, Pharmaleader, Gene Medicals, Project Hope, DSHSM - Fushe Kosove permes human bridge, LUX DEV, OPHARM, Shaha Thaci dhe emisioni n'frekuence ATV, NLB, CFKK, AMC, Familja Gashi, Deltapharm, QKMF Obiliq dhe Human Bridge, Familja ASANAJ, Medimax ShPK, CFKK, Familja Krasniqi, MEDIMAX ShPK, Human Bridge Suedi, ËFH, KFOR Italian CIMIC, AMIK, AMC, Italmed, Project Hope, Care for Kosovo kids dhe studentet nga Holanda, DEVOLLI, Nicola Cardielli & fondazione Cure2children, Shoqata Iniciativa, Galenica part og group NC, AGS, Italmed, U.S. European Command, Humanitarian Assistance Program EUCOM HA, Care for Kosovo kids, IPKO, RLN Advisors, UNFPA, Kryqi i kuq KS, Ambasada e Belgjikes dhe NTP butterfly, Asgeto, KEIS, CDF, BIOHIT, Madekos, FMF, Arber dreshaj dhe Angelo sansone, MEDICA, AGANI, shoqata bamirese “Jetimet e Ballkanit” brupharm, linda impex, ekolog international, exclusive, uje rugove dhe libraria buzuku, novartis, OBSH, IQARUS - bond steel, GIZ, OJQ’Jeta Vita” dhe institucionet tjera, për të cilat do ju jemi mirënjohës për kontributin e secilit veç e veç në përkrahjen e dhënë.

22. Të hyrat në SHSKUK sipas viteve Janar-Dhjetor 2022/2023

Gjatë vitit 2023 të hurat në njësit e SHSKUK-së janë 3,871,888.90 euro. Nga këto të hyra 3,759,914.90 të hyra vetanake ndërsa 111,974.00 Te hyrat nga grandet e percaktuar (donacion Qeveria Japoneze).

Nëse krahasoj me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 2022, kemi ngritje të hyrave prej 636,860.28 euro apo 16 %. Ngritja e të hyrave është për shkak donacioneve të pranuaras, rritjes së numrit të shërbimeve shëndetësore, ekzaminime dhe participimet tjera të mbledhuara nga njësit e SHSKUK-së.

Te hyrat Janar-Dhjetor 2022/2023	
Viti	Vlera
Viti 2023	3,759,914.90
Te hyrat nga grandet e percaktuar (donacion Qeveria Japoneze)	111,974.00
Total i te hurave 2023	3,871,888.90
Vitit 2022	3,235,028.62
Dallimi 2023/2022	636,860.28
Dallimi i te hyrave në %	16%

22.1. Realizimi buxhetit në SHSKUK për periudhën Janar-Dhjetor 2023

Sipas Ligjit Nr. 08/L-193 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, për SHSKUK-së, dhe plotësim-ndryshimi i buxhetit gjatë vitit fiskal sipas kategorive janë planifikuar si më poshtë:

- ✓ **Paga dhe shtesa** janë planifikuar 63,071,047.00 €, kurse me ndryshime buxhetore janë planifikuar 84,535,558.89 kurse janë realizuar 84,532,480.79 € apo 100%.
- ✓ Për kategorin **Mallërat dhe shërbimet** të planifikuara 59,006,346.00 €, me ndryshim buxhetor është rritë vlera në 60,239,765.45 €, kurse janë realizuar 58,769,655.64 € apo të shprehura në përqindje 97.6 %.
- ✓ Në kategorin **shpenzime komunale** janë planifikuar 3,639,016.00 €, me ndryshime buxhetore është rritë në 4,279,016.00 €, kurse janë realizuar 4,175,219.91 € apo në përqindje kemi 97.6 % të realizimit.
- ✓ Ndërsa në kategorin **shpenzime kapitale** të planifikuar kanë qenë 13,949,500.00 €, me ndryshime buxhetore janë përcaktuar 8,035,664.00 €, kurse janë shpenzuar 7,239,336.62 €. Apo në përqindje kemi 90.1% të realizimit buxhetor.

Janar-Dhjetor 2023					
Realizimi i buxhetit të SHSKUK	Paga dhe shtesa	Mallërat dhe Shërbimet	Shpenzimet komunale	Shpenzimet Kapitale	Shpenz. Total
Total buxheti i planifikuar për vitin 2023 për SHSKUK, sipas Ligjit të aprovuar	63,071,047.00	59,006,346.00	3,639,016.00	13,949,500.00	139,665,909.00
Te planifikuara TM4 (ndryshimi i buxhetit gjatë vitit fiskal 2023)	84,535,558.89	60,239,765.45	4,279,016.00	8,035,664.00	157,090,004.34
Te realizuara TM4	84,532,480.79 €	58,769,655.64 €	4,175,219.91 €	7,239,336.62 €	154,716,692.96 €
Obligime TM4	3,078.10	1,470,109.81	103,796.09	796,327.38 €	2,373,311.38
% e realizimit TM4	100.0%	97.6%	97.6%	90.1%	98.5%

Table 20, realizimi i buxhetit të planifikuar për SHSKUK 2023

Pra shpenzimet totale të planifikuara për periudhën për SHSKUK për vitin 2023, vlera e të cilës është planifikuar 139,665,909.00 kurse me ndryshim të buxhetit fiskal ky është rritë 157,090,004.34 €, kurse janë shpenzuar 154,716,692.96 € apo të shprehura në përqindje 98.5%

22.2. Obligimet e SHSKUK-së

Sipas planifikimit dhe shkallës së realizimit të kategorive buxhetore për periudhën Janar-Dhjetor 2023 në SHSKUK, si obligime të mbetur gjatë kësaj periudhe janë gjithësej 2,373,311.38 euro nga shuma e përgjithshme e planifikuar. Obligimet e mbetura lidhen kryesisht me procedurat të katër kategorit ekonomike.

- Paga dhe shtesa kemi **3,078.10 €**.
- Për Mallërat dhe shërbimet Obligime të mbetura janë **1,470,109.81 €**
- Shpenzime komunale obligime të mbetura kemi **103,796.09 €** kurse në kategorin
- Shpenzime kapitale kemi **796,327.38 €**.

23. Objektivat dhe aktivitetet e realizuara Janar-Dhjetor 2023

Sipas planit të punës së SHSKUK-së për vitin 2023, i përbërë prej 11 objektiva dhe 77 aktivitete, të planifikuara sipas afateve kohore për realizimin

Gjatë kësaj kohe kanë përfunduar 23 aktivitete apo 30%, aktivitete në proces janë 35 apo 45% dhe 19 aktivitete apo 24% janë të pa përfunduara.

Objektivi 1- Furnizimi i qëndrueshëm dhe i rregullt me barna dhe material shpenzues mjekësorë

Në kuadër të këtij objektivi është paraparë planifikimi i drejtë dhe efikas për furnizim me barna dhe material shpenzues, menaxhimi efektiv i kontratave për furnizim me barna dhe material medicinal, inicimi i procedurave të prokurimit me kohë dhe trajnimi i menaxherëve të kontratave. Inicimi i kërkesave me kohë dhe shpërndarja e tyre sipas afateve kohore me qëllim të plotësisht të nevojave të institucioneve të SHSKUK. Në këtë objektivi janë paraparë 4 aktivitete, ku 2 aktivitete janë realizuar apo 50% dhe 2 janë në proces apo 50%, sipas planifikimit.

Aktivitetet e përfunduar:

I.2. Shpërndarja e produkteve medicinale në kohë sipas kërkesave të njësive respective

I.3. Bashkëpunim i ngushtë me donatorët për furnizim me barna dhe material shpenzues.

Këto aktivitete edhe pse llogariten si të përfunduara ato vazhdojnë të jenë një nga aktivitete kryesore deri në një furnizim të plotë dhe të rregullt, ku synimi kryesorë për menaxhmentin e SHSKUK-së është furnizimi i rregullt i institucioneve me barëna dhe material shpenzues dhe furnizim me pajisje mjekësore.

Aktivitete në proces

I.1. Furnizimi i qëndrueshëm me barna dhe material shpenzues medicinal

I.4. Ngritja e kontrollit të shpenzimeve të barnave dhe materiait shpenzues medicinal

Objektivi II- Reduktimi i listës së pritjes së pacientëve

Sipas planit të punës nga ky objektiva për këtë periudhë ka paraparë të filloj implementimi i 6 aktiviteteve, me qëllim të uljes së listave të pritjes për kryerjen e shërbimeve në SHSKUK, trajtimit me kohë dhe rritjes së shërbimeve shëndetësore sipas nevojave të institucioneve. Nga 6 aktivitete të parapara për këtë periudhë kanë përfunduar 2 apo 33% dhe 4 aktivitete janë në proces apo 67%.

Aktivitete të përfunduar:

II.5. Funksionalizimi i Rezonancës Magnetike në Spitalin e Pejës dhe Spitalin Pediatrik do të ndikojë dukshëm në reduktimin e listave të pritjes në Klinikën e Radiologjisë për Rezonancë Magnetike

II.6. Vazhdimi i operimit të venave varikoze me radiofrekvenca do të ndikojë në reduktimin e listave të pritjes për venat varikoze, sepse bëhet me anestezion lokal, pa patur nevojë për angazhimin e anesteziologut.

Aktivitetet në proces janë:

II.1. Revidimi/rishikimi i listave të pritjes është planifikuara për periudhat

II.2. Hartimi i planit të veprimit për reduktimin e listave të pritjes

II.4. Sigurimi i resurseve të nevojshme (burimet në njerëz dhe buxheti) për zbatimin e planit të veprimit, si dhe zbatimi i planit për reduktimin e listave të pritjes

Pra këto aktivitete janë në proces të realizimit të përcaktuara edhe në perioda tjera kohore.

Objektivi III-Kontrolli dhe parandalimi i Infeksioneve brendasptalore

Për realizimin e këtij objektivi janë paraparë 8 aktivitete të nevojshme, deri në përfundim të vitit ka përfunduar vetëm 1 aktivitet apo të shprehur në përqindje 13% dhe 6 aktivitete tjera janë në proces apo 74% dhe 1 aktivitet është i pa përfunduar 13%

Aktivitete të përfunduar

III.1. Funksionalizimi i Këshillit për infeksione spitalore

Aktivitete në proces janë

III.2. Vendosja e zonave të filtrit në të gjitha blloqet operative të klinikave të QKUK-së dhe së paku në 50% të sallave kirurgjike në Spitalet e Përgjithshme

III.3. Zhvillimi i PSO për sallat kirurgjike dhe njësitë e kujdesit intensiv

III.4. Sigurimi i uniformës dhe mbathjes së mjaftueshme për personelin e sallave operative /kirurgjike, dezinfektimi i rregullt i sallave kirurgjike

III.5. Furnizimi me carshafa, mbulesa dhe mbështjellës të jastëkut për shtretërit e pacientëve; si dhe sigurimi i uniformes dhe mbathjes së mjaftueshme për personelin shëndetësor dhe mbështetës;

III.7. Gjurmimi (Screening) për bakterie shumë rezistente në njësitë më të ndjeshme (vulnerable),

III.8. Zvogëlimi i prevalencës së infeksioneve në HCV Qendrat e Dializës në SHSKUK

Aktivitete të përfunduara janë:

III.6. Krijimi i njësisë për pastrim dhe dezinfektim të shtretërve në QKUK,

Objektivi IV, Themelimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Në kuadër të këtij objektivi janë paraparë 18 aktivitete në përgjithësi, ku 7 aktivitete kanë përfunduar apo të shprehura në përqindje 39%, Ndërsa 7 aktivitete janë në proces apo 39% dhe 4 aktivitete janë të pa përfunduara apo 22%. Aktivitete të ndryshme në themelimin dhe funksionalizimin e shërbimeve të reja, përmirësimin e shërbimeve, trajnimet për stafin, zgjerimin e hapsirave nëpër klinika dhe njësit tjera të SHSKUK-së.

Aktivitete të përfunduara janë:

IV.3. Avancimi dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve mikrobiologjike në Shërbimin Mikrobiologjik të QKUK

IV.4. Themelimi/Funksionalizimi i Qendres për trajtimin e Infarktit Akut të Trurit (Embolizimi, Coiling, Trombectomi);

IV.11. Rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve oftalmologjike, si në pjesën diagnostike ashtu edhe në atë operative në Klinikën e Oftalmologjisë

IV.12. Sigurimi i vazhdimësisë së punës në Njësinë e Elektrofiziologjisë së Zemrës në Kl. e Kardiologjisë,

IV. 13. Trajtimi stomatologjik i pacienteve me sedacion inhalator (oksidul-azot)

IV. 14. Aplikimi i terapisë fikse ortodontike

IV. 15. Furnizimi me unit kirurgjik dhe pjesamentë kirurgjikë me qëllim të përmirësimit të punës dhe pergaditja per aplikimin e terapise me implante dentare

Ndërsa aktivitete të cilat janë në proces:

IV.1 Themelimi i Shërbimit të Transportit Neonatal në Klinikën Pediatrike në QKUK

IV.5. Themelimi i Njesisë Fetale në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike;

IV.7. Funksionalizimi i endoskopisë pediatrike (bronhoskopia, gastroskopia dhe kolonoskopia);

IV.8. Funksionalizim i kirurgjisë laparoskopike dhe nefrolitotomisë perkutane në Klinikën e Urologjisë;

IV.9. Funksionalizimi i Laboratorëve diagnostike patologjike dhe citologjike në të gjitha Spitalet e Përgjithshme,

IV.16 Fillimi i realizimit të projektit për sallën kirurgjike Endovaskulare në Kirurgji Vaskulare

IV.17 Fillimi i realizimit të projektit për sallën e Neurokirurgjisë.

Aktivitetet të pa përfunduara

IV.2. Themelimi i njesisë së Fertilizimit të Asistuar Mjekësorë në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike;

IV.6. Themelimi i njesisë për përcjelljen e pacientëve para dhe pas transplantimit të veshkës në kuadër të Klinikës së Nefrologjisë

IV.10 Zbatimi i Planit të veprimit për furnizim të qytetarëve me proteza, ortoza dhe shërbime tjera të cilat ofrohen në SHKOP/SHSKUK ,

IV.18. Fillimi i shërbimeve specialistike në Spitalin e Podujevës,

Objektivi V- Menaxhimi efikas, rritja e transparencës dhe llogaridhënies

Sipas planit të punës në këtë objektiv janë planifikuar 8 aktivitete të ndryshme ku 2 prej tyre janë përfunduar apo 25% e tyre. Aktivitetet të cilat janë në proces të përfundimit janë 4 apo 50% e tyre dhe aktivitetet të planifikuar dhe të pa realizuara janë 3 aktivitete apo 38%. Sipas planifikimit të këtij objektivi, aktivitete kanë të bëjnë në hartimin dhe miratimin e rregulloreve të brendshme për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, rregulloreve për organizimin e punës në të gjitha klinikat e QKUK, Planin e burimeve njerëzore, fuqizimi i komunikimit të drejtpërdrejtë dhe sistematik të SHSKUK me qytetarët dhe shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe ngritjen e cilësisë së raporteve periodike dhe vjetore të njësive të SHSKUK.

Aktivitetet të përfunduara

V.5. Azhurimi i rregullt i ëeb faqes së SHSKUK/QKUK,

V.6. Fuqizimi i komunikimit të drejtpërdrejtë dhe sistematik të SHSKUK me qytetarët dhe shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve.

Ndërsa aktivitetet që janë në proces:

V.4. Hartimi i planit të burimeve në njerëz-planifikimi i trajnimit dhe shfrytëzimi efikas i burimeve njerëzore (tregues matës për vlerësimin e stafit).

"V.5. a. Publikimi i shërbimeve mjekësore që ofrohen në secilën Njësi Përbërëse të SHSKUK-së, duke përfshirë çmimorën e shërbimeve dhe numrat e kontaktit të telefonit për secilën njësi;

V.5. b. Publikimi i orarit të punës së ambulancave specialistike të të gjitha Njësive Përbërëse të SHSKUK-së, përfshirë emrat e mjekëve dhe një numër kontakti për caktimin e terminëve; "

V.7. Vlerësimi i motivimit të stafit shëndetësor dhe vlerësimi(matja) e knaqshmërisë së pacientëve dhe shërbimit shëndetësor

V.8 Ngrijta e cilësisë së raporteve periodike dhe vjetore nga të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK

Aktivitetet e pa përfunduara

V.1. Hartimi dhe miratimi i Rregullores për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës

V.2. Hartimi dhe miratimi i rregullores për organizimin e punës në të gjitha klinikat e QKUK;

V.3. Hartimi dhe implementimi i nje plani te trajnimit me tema te nevojshme profesionale per stafin e administrates se SHSKUK

Objektivi VI- Furnizimi me pajisje mjekësore, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre e rregullt

Në kuadër të këtij objektivi janë përcaktuar 6 aktivitete në përgjithësi, ku janë realizuara 4 aktivitete apo 67% dhe 2 aktivitete është mbete në proces apo 33%. Aktivitete kishin të bëjnë me sigurimin e pajisjeve të ndryshme dhe hartimin e planit për servisim dhe servisimin e rregullt të pajisjeve mjekësore.

Aktivitetet e përfunduara janë:

VI.1,3,4,5.: Sigurimi i një akceleratori të ri për radioterapi për nevojat e Klinikës së Onkologjisë,

VI.2. Sigurimi i aparatit për Plazmaferezë - të përbashkët për nevojat e Klinikave të QKUK;

VI. 2, 7. Pajisjet për FAM, oftalmologji si dhe disa pajisje të tjera bashkëpunim me MSh.

Sigurimi e Autoambulancës për transportin neonatal,

VI.6. Servisimi i rregullt dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore – hartimi i planit operativ për servisim dhe mirëmbajtje.,

Aktivitetet në proces

VI.4. Sigurimi i pajisjeve mjekësore të nevojshëm për laobartoret e histopatologjisë për Spitalet e Përgjithshme.

VI.5. Sigurimi i pajisjeve mjekësore bazuar në prioritetet e njësive të ShSKUK

Objektivi VII- Përmirësimi dhe zgjerimi i ambienteve spitalore– investimet kapitale

Bazuar në planin e punës për implementimin e këtij objektivi janë planifikuar gjithsej 9 aktivitete për krijimin e hapsirave të nevojshme për shërbime shëndetësore, vazhdimisht që janë në evoluim, procedurave të reja diagnostike ashtu edhe në qasjen të integruar sa i takon trajtimit spitalor. Nga aktivitetet e planifikuara janë realizuar 3 aktivitete apo 33%, aktivitetet të cilat janë në proces janë 4 apo 44% dhe aktivitete të pa realizuara janë 2 apo 22%,

Aktivitetet e përfunduara

VII.3. Mbindërtimi i sallës së kateterizimit-kardiologjia invazive në SP të Prizrenit-Vazhdim

VII.6. Renovimet në klinikat e QKUK sipas prioriteteve në bashkëpunim me MSh

VII.9. Furnizimi me inventar medicinal dhe administrativ në QKUK

Aktivitetet e përcaktuara që janë në proces:

VII.1. Ndërtimi i Spitalit për nëna dhe fëmijë në Prizren-Vazhdim

VII.4. Ndërtimi i Aneksit të Klinikës së Ortopedisë në QKUK-Vazhdim

VII.7. Adaptimi i infrastrukturës për personat me nevoja te veçanta,

VII.8. Rregullimi i nyjeve sanitare në hapësirat e QKUK dhe njësive tjera të SHSKUK

Aktivitetet e pa përfunduara janë:

VII.2. Fillimi i ndërtimit të Klinikës së Nefrologjisë dhe Hematologjisë

VII.5. Hartimi i projektit ideor për depon qendrore të barnave dhe materialit shpenzues mjekësor për ShSKUK.

Objektivi VIII. Digjitalizimi i sistemeve në kuadër disa shërbimeve në QKUK në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Objektivi VIII ka paraparë 6 aktivitete që kanë të bëjnë me zgjerimin dhe digjitalizim të sistemit në regjistrimin e resurseve, pacientëve të hospitalizuar dhe mundësisë për PACS në SHSKUK. Këto aktivitete janë paraparë të fillojnë në këtë periudhë dhe të vazhdojnë edhe në pjesët tjera të këtij viti. Gjatë kësaj periudhe 3 aktivitete janë në proces apo 50% dhe 3 aktivitete janë të pa përfunduara apo 50% e tyre.

Aktivitetet e cila janë në proces:

VIII.1. SMSF: funksionalizimi në tërësi i sistemit në fjalë;

VIII.2. Zgjerimi i rrjetit të digjitalizimit dhe terminëve në të gjitha ambulancat specialistike në kuadër të QKUK-së;

VIII.3. Sistemi për regjistrim të resurseve humane dhe vijueshmëri;

Aktivitetet e pa përfunduara janë:

VIII.4. Fillimi i aktivizimit të sistemit digjital të regjistrimit të pacientëve (Pilot projekt- Klinika e Onkologjisë);

VIII.5. Mundësia e aktivizimit të PACS në kuadër të ShSKUK-së;

VIII.6. Mundësia e digjitalizimit të sistemit të alarmit të pacientëve të hospitalizuar.

Objektivi IX. Përgatitja e planit të detajuar për reagim në emergjencë;

Ky objektivi ka paraparë gjithsej 4 aktivitete, që përfshijnë përgatitjen e planit të detajuar dhe masat e nevojshme për reagim emergjent dhe menaxhimin e pandemisë COVID-19 dhe në rastet tjerë të nevojshme. Nga aktivitete e planifikuara 1 ka përfunduar apo 25% 3 aktivitete janë të pa përfunduara apo 75%.

Aktivitetet e përfunduara;**IX.4. Menaxhimi i Pandemisë COVID-19:**

Aktivitetet e pa përfunduara janë:

IX.1. Përgatitja e planit të detajuar për reagim në emergjencë;

IX.2. Krijimi i grupit punues për përpilimin e planit të detajuar për reagim në emergjencë për të gjitha objektet spitalore;

IX.3. Trajnimi i stafit për reagim në situata emergjente.

Objektivi X. Kontrollimi mjekësorë sistematik i stafit të ShSKUK-së

Nga ky objektivi janë planifikuar 2 aktivitete të cilat kanë për qëllim realizimin e kontrollave mjekësore për të punësuarit e SHSKUK. Nga këto aktivitete janë realizuar 1 aktivitet dhe 1 aktivitet është në proces.

Aktivitetet e përfunduara janë:

X.2. Krijimi i në grupi që do të përpilojë planin e detajuar për implementimin e këtij projekti;

Aktivitetet tjera që janë në proces;

X.1. Kontrolli sistematik i personelit shëndetësor dhe mbështetës.

Tashmë ky grup punues është duke punuar me qëllim të implementimit të projektit për kontrollat sistematike për punëtorët SHSKUK. Kontrollat sistematike sipas planit të veprimit do të vazhdojnë deri në TM4.

Objektivi XI. Reforma Administrative

Objektivi i planifikuar parashef 5 aktivitete për plotësime -ndryshimet e statuteve të SHSKUK dhe njësisve tjera. Sipas afateve të parapara 2 aktivitete apo 40% janë në proces dhe 3 aktivitete apo 60% janë të pa përfunduar.

Aktivitetet të cilat janë në proces:

XI.1. Plotësim ndryshimi i Statutit të ShSKUK

XI.3. Plotësim ndryshimi i Statutit të QSKUK

Aktivitetet e pa përfunduara janë:

XI.2. Plotësim ndryshimi i Statutit të QKUK

XI.4. Plotësim ndryshimi i Statutit të Spitaleve Rajonale

XI.5. Hartimi i Rregullores për sistematizim dhe përshkrim të vendeve të punës në njësitë përbërse të ShSKUK

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË SHSKUK-SË, JANAR-DHJETOR 2023

Objektivat dhe aktivitetet sipas planit të punës së SHSKUK-së, Janar-Dhjetor 2023						
Nr	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET	AFATI KOHOR	Aktivitetet të përfundua	Aktivitetet në proces	Aktivitetet pa përfunduar
	Furnizimi i qëndrueshëm dhe i rregullt me barna dhe material shpenzues mjekësorë	I.1. Furnizimi i qëndrueshëm me barna dhe material shpenzues medicinal	TM1/2/3/4		X	
		II.2. Shpërndarja e produkteve medicinale në kohë sipas kërkesave të njëjësive respektive	TM1/2/3/4	X		
		I.3. Bashkëpunimi i ngushtë me donatorët për furnizim me barna dhe material shpenzues	TM1/2/3/4	X		
		I.4. Ngritja e kontrollit të shpenzimeve të barnave dhe materiait shpenzues medicinal	TM1/2/3/4		X	
II	Reduktimi i listës së pritjes së pacientëve	II.1.Revidimi/rishikimi i listave të pritjes;	TM1/2/3/4		X	
		II.2. Hartimi i planit të veprimit për reduktimin e listave të pritjes;	TM2/3/4		X	
		II.3.Prioritizimi i sëmundjeve – patologji për reduktimin e listave të pritjes	TM2/3/4		X	
		II.4. Sigurimi i resurseve të nevojshme (burimet në njerëz dhe buxheti) për zbatimin e planit të veprimit, si dhe zbatimi i planit për reduktimin e listave të pritjes;	TM2/3/4		X	
		II.5.Funksionalizimi i Rezonancës Magnetike në Spitalin e Pejës dhe Spitalin Pediatrik do të ndikojë dukshëm në reduktimin e listave të pritjes në Klinikën e Radiologjisë për Rezonancë Magnetike	TM 2/3/4	X		
		II.6.Vazhdimi i operimit të venave varikoze me radiofrekvencë do të ndikojë në reduktimin e listave të pritjes për venat varikoze, sepse bëhet me anestezion lokal, pa patur nevojë për angazhimin e anesteziologut.	TM 2/3/4	X		
III.	Kontrolli dhe parandalimi i Infeksioneve brendasptalore	III.1. Funksionalizimi i Këshillit për infeksione spitalore	TM 1	X		
		III.2.Vendosja e zonave të filtrit në të gjitha blloqet operative të klinikave të QKUK-së dhe se paku në 50% të sallave kirurgjike në Spitalet e Përgjithshme	TM2/3		X	
		III.3. Zhvillimi i PSO për sallat kirurgjike dhe njësitë e kujdesit intensiv	TM2/3		X	
		III.4.Sigurimi i uniformës dhe mbathjes së mjaftueshme për personelin e sallave operative /kirurgjike, dezinfektimi i rregullt i sallave kirurgjike	TM1/2/3/4		X	
		III.5. Furnizimi me carshafa, mbulesa dhe mbështjellës të jashtëkut për shtrëritë e pacientëve; si dhe sigurimi i uniformes dhe mbathjes së mjaftueshme për personelin shëndetësor dhe mbështetës;	TM1/2/3/4		X	
		III.6. Krijimi i njësisë për pastrim dhe dezinfektim të shtrëtrëve në QKUK,	TM2/3			X
		III.7. Gjurmimi (Screening) për bakterie shumë rezistente në njësitë më të ndjeshme (vulnerable),	TM2/3/4		X	
		III.8. Zvogëlimi i prevalencës së infeksioneve në HCV Qendrat e Dializës në SHSKUK	TM2/3/4		X	
IV	Themelimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore	IV.1 Themelimi i Shërbimit të Transportit Neonatal në Klinikën Pediatrisë në QKUK	TM2		X	
		IV.2 Themelimi i njësisë së Fertilizimit të Asistuar Mjekësorë në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike;	TM4			X
		IV.3.Avacimi dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve mikrobiologjike në Shërbimin Mikrobiologjik të QKUK	TM2	X		
		IV.4. Themelimi/Funksionalizimi i Qendres për trajtimin e Infarktit Akut të Trurit (Embolizimi,Coiling,Trombectomi);	TM4		X	
		IV.5.Themelimi i Njësisë Fetale në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike;	TM2/3/4	X		
		IV.6.Themelimi i njësisë për përcjelljen e pacientëve para dhe pas transplantimit të veshkës në kuadër të Klinikës së Nefrologjisë	TM 3/4			X
		IV.7. Funksionalizimi i endoskopisë pediatrike (bronhoskopia, gastroskopia dhe kolonoskopia);	TM3/4		X	
		IV.8.Funksionalizimi i kirurgjisë laparoskopike dhe nefrolitotomisë perkutane në Klinikën e Urologjisë;	TM1/2/3		X	
		IV.9. Funksionalizimi i Laboratorëve diagnostike patologjike dhe citologjike në të gjitha Spitalet e Përgjithshme,	TM2/3/4		X	
		IV.10 Zbatimi i Planit të veprimit për furnizim të qytetarëve me proteza, ortoza dhe shërbime tjera të cilat ofrohen në SHKOP/SHSKUK ,	TM2-TM3			X
		IV.11.Rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve oftalmologjike, si në pjesën diagnostike ashtu edhe në atë operative në Klinikën e Oftalmologjisë	TM3/4	X		
		IV.12. Sigurimi i vazhdimësisë së punës në Njësinë e Elektrofiziologjisë së Zembrës në Kl. e Kardiologjisë,	TM1/2/3/4	X		
		IV. 13. Trajtimi stomatologjik i pacientëve me sedacion inhalator (oksidul-azot)	TM2/3	X		
		IV. 14. Aplikimi i terapisë fikse ortodontike	TM1	X		
		IV. 15. Furnizimi me unit kirurgjik dhe pjesamentë kirurgjikë me qëllim të përmirësimit të punës dhe pergaditja për aplikimin e terapi me implante dentare	TM4		X	
		IV.16 Fillimi i realizimit të projektit për sallën kirurgjike Endovaskulare në Kirurgji Vaskulare	TM3/4		X	
		IV.17 Fillimi i realizimit të projektit për sallën e Neurokirurgjisë.	TM3/4	X		
		IV.18. Fillimi i shërbimeve specialiste në Spitalin e Podujevës,	TM 3/4			X

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË SHSKUK-SË, JANAR-DHIJETOR 2023

V	Menaxhimi efikas, rritja e transparencës dhe llogaridhënies	V.1. Hartimi dhe miratimi i Rregullores për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës	TM 2			X
		V.2.Hartimi dhe miratimi i rregulloreve për organizimin e punës në të gjitha klinikat e QKUK;	TM/1/2/3			X
		V.3. Hartimi dhe implementimi i nje plani te trajnimit me tema te nevojshme profesionale per stafin e administrates se SHSKUK	TM2/3/4			X
		V.4. Hartimi i planit të burimeve ne njerëz-planifikimi i trajnimit dhe shfrytëzimi efikas i burimeve njerzore (tregues mates per vlersimin e stafit)	TM2/3/4		X	
		V.5. Azhurimi i rregullt i web faqes se SHSKUK/QKUK,	TM2/3/4	X		
		V.5. a. Publikimi i shërbimeve mjekësore që ofrohen në secilën Njësi Përbërëse të SHSKUK-së , duke përfshirë çmimorën e shërbimeve dhe numrat e kontaktit te telefonit për secilën njësi;			X	
		V.5. b. Publikimi i orarit të punës së ambulancave specialistike të të gjitha Njësive				
		V.6. Fuqizimi i komunikimit të drejtpërdrejtë dhe sistematik i SHSKUK me qytetarët dhe shoqatata për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve.		X		
		V.7.Vlerësimi i motivimit të stafit shëndetësor dhe vlerësimi(matja) e knaqshmërisë së pacientëve dhe shërbimit shëndetësor			X	
V.8 Ngrija e cilësisë së raporteve periodike dhe vjetore nga të gjitha njësitë përbërëse të SHSKUK	TM/3/4		X			
VI	Furnizimi me pajisje mjekësore, servisini dhe mirëmbajtja e tyre e rregullt	VI.1,3,4,5.: Sigurimi i një akceleratori të ri për radioterapi për nevojat e Klinikës së Onkologjisë,	TM 3/4	X		
		VI.2.Sigurimi i aparatit për Plazmaferezë - të përbashkët për nevojat e Klinikave të QKUK;		X		
		VI.4. Sigurimi i pajisjeve mjekësore te nevojshëm për laobartoret e histopatologjise për Spitalet e Përgjithshme.			X	
		VI.5. Sigurimi i pajisjeve mjekësore bazuar në prioritetet e njësive të ShSKUK	TM 3/4		X	
		VI. 2. 7. Pajisjet per FAM, oftalmologji si dhe disa pajisje të tjera bashkëpunim me MSh. Sigurimi e Autoambulancës për transportin neonatal,	TM3/4	X		
		VI.6. Servisini i rregullt dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore – hartimi i planit operativ për servisin dhe mirëmbajtje.	TM 1/2/3/4	X		
VII.	Përmirësimi dhe zgjerimi i ambienteve spitalore– investimet kapitale	VII.1.. Ndërtimi i Spitalit për nëna dhe fëmijë në Prizren-Vazhdim	TM1/2/3/4		X	
		VII.2. Fillimi i ndërtimit të Klinikës së Nefrologjisë dhe Hematologjisë	TM3/4			X
		VII.3.. Mbindërtimi i sallës së kateterizimit-kardiologjia invazive në SP të Prizrenit-Vazhdim	TM3/4	X		
		VII.4. Ndërtimi i Aneksit të Klinikës së Ortopedisë në QKUK-Vazhdim	TM2/3/4		X	
		VII.5. Hartimi i projektit ideor për depon qendrore të barnave dhe materialit shpenzues mjekësor për ShSKUK.	TM2/3			X
		VII.6.Renovimet ne klinikat e QKUK sipas prioriteteve ne bashkëpunim me MSh	TM2/3/4	X		
		VII.7.Adaptimi i infrastrukturës për personat me nevoja te veçanta,	TM2/3/4		X	
		VII.8. Rregullimi i nyjeve sanitare në hapësirat e QKUK dhe njësive tjera të SHSKUK	TM2/3/4		X	
		VII.9.Furnizimi me inventar medicinal dhe administrativ në QKUK	TM2/3/4	X		
VIII	Digjitalizimi i sistemeve në kuadër disa shërbimeve në QKUK në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë;	VIII.1. SMSF: funksionalizimi në tërësi i sistemit në fjalë;	TM2/3/4		X	
		VIII.2. Zgjerimi i rrjetit të digjitalizimit dhe terminëve në të gjitha ambulancat specialistike ne kuadër të QKUK-së;	TM2/3/4		X	
		VIII.3. Sistemi për regjistrim të resurseve humane dhe vijueshmëri;	TM2/3/4		X	
		VIII.4. Fillimi i aktivizimit të sistemit digjital të regjistrimit të pacientëve (Pilot projekt- Klinika e Onkologjisë);	TM2/3/4			X
		VIII.5. Mundësia e aktivizimit të PACS në kuadër të ShSKUK-së;	TM2/3/4			X
		VIII.6. Mundësia e digjitalizimit të sistemit të alarmit të pacientëve të hospitalizuar.	TM2/3/4			X
		IX	Përgatitja e planit të detajuar për reagim në emergjencia;	IX.1. Përgatitja e planit të detajuar për reagim në emergjencia;	TM2/3/4	
IX.2. Krijimi i grupit punes për përpilimin e planit të detajuar për reagim në emergjencia për të gjitha objektet spitalore;	TM2/3/4					X
IX.3. Trajnimi i stafit për reagim në situata emergjente.	TM2/3/4					X
IX.4. Menaxhimi i Pandeminë COVID-19;	TM2/3/4			X		
X	Kontrollimi mjekësorë sistematik i stafit të ShSKUK-së	X.1. Kontrolli sistematik i personelit shëndetësor dhe mbështetës X.2. Krijimi i nën grupi që do të përpilojë planin e detajuar për implementimin e këtij projekti;	TM2/3		X	
XI.	Reforma Administrative	XI.1. Plotësim ndryshimi i Statutit të ShSKUK	TM2		X	
		XI.2. Plotësim ndryshimi i Statutit të QKUK	TM2			X
		XI.3. Plotësim ndryshimi i Stautit të QSKUK	TM2		X	
		XI.4. Plotësim ndryshimi i Statutit të Spitaleve Rajonale	TM2			X
		XI.5. Hartimi i Rregullores për sistematizim dhe përshkrim të vendeve të punës në njësitë përbërse të ShSKUK	TM2			X
Total		77		23	35	19
				30%	45%	25%

24.Problemet dhe Sfidat e SHSKUK-së

ShSKUK, shpesh herë po ballafaqohet me problem të natyrave të ndryshme të cilat po krijojnë një imazh jo të knaqëshëm tek qytetarët të cilat po vazhdojnë të përsëriten kohë pasë kohe.

Do të përmendim disa nga problemet dhe sfidat e identifikuara gjatë këtij vitit, të ndara si problemet e brendshme dhe të jashtme, të cilët disa nga to janë:

Nr.	Problemi i brendshëm	Problem i jashtëm	Komente
1	Shfrytëzueshmëria jo e knaqëshme e kapaciteteve të njësive të SHSKUK-së.		Po vazhdon shfrytëzueshmëria jo e knaqshme e kapaciteteve të njësive si pasoj e planifikimit jo të mire dhe organizimeve branda njësive.
2	Mungesa e pajisjeve		Për shkak të mungesës së pajisjeve dhe pjesëve shtesë si dhe procedurave për furnizim po shkakton lista të pritjes dhe referime të pacienteve për trajtim jashtë instucionev publike.
3	Infrastrukturat e objekteve të disa nga njësit e SHSKUK		Mungesa e investimeve po krijojnë, shfrytëzueshmëri jo të mirë të kapaciteteve dhe imazh jo të knaqëshëm për trajtimin e pacientëve sipas standardeve të kërkuara.
4	Burimet njerzore		Trajnimet profesionale, planifikim dhe sistemimi jo mirë i burimeve njerzore, mungesa e disa profileve specialistike, po ndikon në ngritjen dhe cilësinë e shërbimeve dhe në rritjen e shfrytëzueshmëris së kapaciteteve.
5	Aktet e brendshme të SHSKUK-së		Nxjerrja dhe hramonizimi i akteve të brendshme konform legjislacionit në fuqi.
6	Hapsirat e nevojshme për punë, aparaturat dhe pajisjet mjekësore.		Këta janë arsyet për mos ofrim të disa shërbime shëndetësore në institucionet publike dhe kërksa për trajtim jashtë vendit.
7	Roportimet		Mungesa e një programi elektronike për shërbimet e kryera po shkakton pamundësin në vlerësimin me kohe për shërbimet e kryera. Rekomandoj të krijohet një program unik për raportim.
8		Procedurat ligjore të përcaktuara në Ligjin e prokurimit publik në Republikën e Kosovës.	Procedura ligjore dhe planifikimet po ndikon në furnizimin jo të knaqshëm me barna dhe material shpenzues.
9		Mungesa e disa nga barnave në tregun e Kosovës, produkteve që nuk kanë Autorizim Marketingu, interesi nga OE	Disa nga barnat mungojnë në tregun e Kosovës, po ashtu produkte që nuk kanë autorizim marketing dhe shumë na OE nuk konkurojnë për furnizim për shkak të sasisë së vogël dhe interes, liferimi dhe tranzporti.

Table 21 Disa nga problemet dhe sfidat e brendshme dhe të jashtme të SHSKUK